



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Komuna e DEÇANIT **2022**

RAPORTI VJETOR I PUNËS 2022



FJALA HYRËSE E KRYETARIT BASHKIM RAMOSAJ

QYTETARË TË DASHUR TË KOMUNËS SË DEÇANIT,

SI REZULTAT I PUNËVE DHE ANGAZHIMIT GJATË VITIT 2022, NË SHËRBIM TË QYTETIT DHE TË FSHATRAVE TË KOMUNËS SË DEÇANIT, PO JU PREZANTOJMË RAPORTIN E PLOTË VJETOR TË PUNËVE DHE PROJEKTEVE TË PËRMBYLLURA, TË ATYRE QË JANË NË STADE TË NDRYSHME TË ZHVILLIMIT, SI DHE TË PLANIFIKIMIT. VITI 2022 PËR KOMUNËN TONË MUND TË CILËSOHET VIT I ANGAZHIMEVE DHE PËRKUSHTIMIT NË PËRPUTHJE ME PËRGJEGJËSITË LIGJORE NË IMPLEMENTIMIN E OBJEKTIVAVE PËR QEVERISJE KOMUNALE TRANSPARENTE DHE PËRMBUSHJEN E STANDARDEVE PËR QEVERISJE TË MIRË ME IMPAKT NË MIRËQENIEN E QYTETARËVE. KOMUNIKIMI I PËRHERSHËM ME QYTETARË, SUBJEKTE DHE INSTITUCIONE VENDORE E NDËRKOMBËTARE, SHËNOJNË BAZËN E NDËRTIMIT TË PROCESVE VENDIMËMARRËSE DHE TË AVANCIMIT TË PËRFORMANCËS NË MENAXHIM TË ORGANEVE KOMUNALE.

JEMI TË VETËDIJSHËM QË KEMI EDHE SHUMË PUNË PËRPARA POR JAM BETUAR DHE ZOTUAR QË DEÇANIN DO E BËJË, ASHTU SIQË KEMI ËNDËRRUAR GJITHMONË!

SINQERISHT,
BASHKIM RAMOSAJ

PËRMBAJTJA

Hyrje	3
ZYRA E KRYETARIT	3
Zyra për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun	4
Zyra e Prokurimit	8
Zyra e Auditorit të Brendshëm	10
DREJTORIA E ADMINISTRATËS	12
DREJTORIA PËR URBANIZËM, PLANIFIKIM HAPËSINOR DHE MBROJTJE TË MJEDISIT	14
DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA	19
DREJTORIA PËR SHËNDETËSI DHE MIRËQENIE SOCIALE	25
DREJTORIA PËR ARSIM	56
DREJTORIA PËR BUJQËSI, PYLLTARI DHE ZHVILLIM RURAL	70
DREJTORIA PËR MBROJTJE, SHPËTIM DHE SHËRBIME PUBLIKE	73
DREJTORIA PËR INSPEKSION	98
DREJTORIA PËR EKONOMI DHE ZHVILLIM	100
DREJTORIA PËR GJEODEZI DHE KADASTËR	108
DREJTORIA PËR KULTURË, RINI DHE SPORT.....	110

Hyrje

Bazuar në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale dhe Statutin e Komunës së Deçanit i datës 31.10.2019, si dhe në Planin e Punës së Kryetarit dhe Qeverisë Komunale 2022, paraqesim raportin vjetor të punës për vitin 2022.

Raporti pasqyron rezultatet e arritura, aktivitetet dhe angazhimet e drejtorive komunale të komunës së Deçanit si dhe njesive të cilat veprojnë në kuadër të zyrës së kryetarit gjatë periudhës raportuese Janar – Dhjetor 2022.

Zyra e kryetarit gjatë kësaj periudhe është angazhuar maksimalisht për organizimin sa më të mirë të të gjitha aktiviteteve të organizuara nën patronatin e kryetarit të komunës si dhe organizimin e takimeve të ndryshme. Angazhimi kryesor i kryetarit të komunës dhe organeve tjera komunale ka qenë përkushtimi për zbatimin e rendit, ligjit dhe disiplinës në punë.

➤ Zyra e Kryetarit

Në periudhën Janar – Dhjetor 2022 Zyra e Kryetarit të komunës së Deçanit ka kryer këto punë:

- Organizimin e takimeve protokollare të kryetarit të komunës;
- Evidentimin dhe mbikëqyrjen e takimeve të kryetarit të komunës;
- Përgatitjen e takimeve të kryetarit me delegacione të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare, nga niveli qendror dhe lokal;
- Organizimin e takimeve të kryetarit me qytetarët e komunës së Deçanit;
- Organizimin e 2 Mbledhjeve Publike ashtu siç e parasheh Ligji për Vetëqeverisje Lokale;
- Ka pranuar **1,696** lëndë të protokolluara, nga të cilat janë kërkesa, vendime, kontrata, memorandume, marrëveshje, shkresa, njoftime, prej të cilave **1** është në process, **1,617** janë miratuar, **58** janë refuzuar, **17** janë anuluar dhe **3** janë hedhur poshtë.

Nga këto kërkesa **183** prej tyre me vlerë totale prej **152,600** euro, janë bërë vendime për subvencionim të personave me sëmundje malinje, me kushte jo të mira financiare, klubeve sportive, organizatave të ndryshme joqeveritare dhe vendime tjera për mbështetje financiare varësisht nga kërkesa.

➤ **Zyra për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun**

Gjatë kësaj periudhe kohore Zyra për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun në Komunën e Deçanit ka përcjellë në vazhdimësi aktivitetet ditore, javore dhe mujore ku janë publikuar edhe në web faqen zyrtare të komunës <https://kk.rks-gov.net/decan/> dhe në profilin zyrtar të komunës në [Facebook](#).

Kemi publikuar të gjitha aktivitetet e mbajtura dhe të gjitha vendimet, rregulloret, projektet, konkurset, njoftimet e zyrës së prokurimit, njoftimet për dhënie të kontratave, njoftime për shfuqizim të kontratave dhe shkresa të tjera me interes për qytetarët e Komunës së Deçanit.

Zyra për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun ka mbajtur kontakte të rregullta me mediat ku ka përcjellë njoftime, komunikata në bazë të aktiviteteve të zhvilluara në komunën e Deçanit, duke i mbajtur mediat e informuara në vazhdimësi për ngjarjet në Komunën e Deçanit.

Aktivitetet e Zyrës për Komunikim dhe Marrëdhënie me Publikun sipas muajve:

Janar

- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal;
- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komitetit për Komunitete;
- Pjesëmarrja dhe informimi lidhur me mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve;
- Pjesëmarrja në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës si brenda dhe jashtë Komunës, si dhe publikimi i vendimeve të nënshkruara nga Kryetari etj.

Shkurt

- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal;
- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komitetit për Komunitete;
- Pjesëmarrja dhe informimi lidhur me mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve;
- Pjesëmarrja në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës si brenda dhe jashtë komunës, si dhe publikimi i vendimeve të nënshkruara nga kryetari;
- Pjesëmarrja, njoftimi dhe publikimi i aktiviteteve për nder të 17 Shkurtit – Ditës së Pavarësisë së Kosovës etj.

Mars

- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal;
- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komitetit për Komunitete;
- Pjesëmarrja dhe informimi lidhur me mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve;
- Pjesëmarrja në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës si brenda dhe jashtë Komunës, si dhe publikimi i vendimeve të nënshkruara nga Kryetari;
- Pjesëmarrja, njoftimi dhe publikimi i aktiviteteve për nder të 24 Marsit – Epopesë së Dukagjinit;
- Pjesëmarrja, njoftimi dhe publikimi I garës së skijimit “Kupa e Gjeravicës”;
- Dalja në teren – fotografimi dhe video inçizime të projekteve që janë kryer dhe që janë në vazhdim në komunën tonë; fotografimi i viseve malore me qëllim të promovimit të turizmit dhe atraksioneve që ofron Deçani etj.

Prill

- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal;
- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komitetit për Komunitete;
- Pjesëmarrja dhe informimi lidhur me mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve;
- Pjesëmarrja në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës si brenda dhe jashtë Komunës, si dhe publikimi i vendimeve të nënshkruara nga kryetari etj.

Maj

- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal;
- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komitetit për Komunitete;
- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSBB);
- Pjesëmarrja dhe informimi lidhur me mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve;
- Pjesëmarrja në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës si brenda dhe jashtë Komunës, si dhe publikimi i vendimeve të nënshkruara nga Kryetari;
- Pjesëmarrja, njoftimi dhe publikimi i aktiviteteve për nder të 5 dhe 6 Majit – Ditës së Dëshmorëve në Komunën e Deçanit etj.

Qershor

- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal;
- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komitetit për Komunitete;
- Pjesëmarrja dhe informimi lidhur me mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve;
- Pjesëmarrja në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës si brenda dhe jashtë Komunës, si dhe publikimi i vendimeve të nënshkruara nga Kryetari;
- Pjesëmarrja, njoftimi dhe publikimi i aktiviteteve me rastin e 1 Qershorit - Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve;
- Pjesëmarrja, njoftimi dhe publikimi i aktiviteteve për nder të 16 Qershorit – Ditës së Çlirimit të Deçanit;
- Pjesëmarrja, njoftimi dhe publikimi i aktivitetit “Panairi Veror Deçani 2022”;
- Publikimi i mbajtjes së diskutimeve publike në lidhje me Qarkoren Buxhetore 2023/01;
- Publikimi i takimit të parë publik me qytetarë i Kryetarit, z. Bashkim Ramosaj;
- Dalja në teren – fotografimi i viseve malore me qëllim të promovimit të turizmit dhe atraksioneve që ofron Deçani.

Korrik

- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal;
- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komitetit për Komunitete;
- Pjesëmarrja dhe informimi lidhur me mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve;
- Pjesëmarrja në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës si brenda dhe jashtë Komunës, si dhe publikimi i vendimeve të nënshkruara nga Kryetari;
- Përcjellja dhe informimi i aktiviteteve të shumta të AKV “Deçani”, në festivale e koncerte si brenda ashtu dhe jashtë vendit;
- Pjesëmarrja, njoftimi dhe informimi i organizimeve të ndryshme për bashkatdhetarët.

Gusht

- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal;
- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komitetit për Komunitete;
- Pjesëmarrja dhe informimi lidhur me mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve;

- Pjesëmarrja në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës si brenda dhe jashtë Komunës, si dhe publikimi i vendimeve të nënshkruara nga Kryetari;
- Pjesëmarrja, njoftimi dhe publikimi i aktiviteteve të Panairit Veror me produktet e prodhuesve Deçanas;
- Përcjellja dhe informimi i çdo aktiviteti me punët që kanë filluar dhe po vazhdojnë të punohen në komunën tonë;
- Publikimi i aktiviteteve të organizuara nga Qendra Informuese Turistike, me qëllim të promovimit dhe zhvillimin ekonomik të qytetit;

Shtator

- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal;
- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komitetit për Komunitete;
- Pjesëmarrja dhe informimi lidhur me mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve;
- Pjesëmarrja në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës si brenda dhe jashtë Komunës, si dhe publikimi i vendimeve të nënshkruara nga Kryetari;
- Përcjellja, njoftimi dhe publikimi i të gjitha debateve publike për projekt-buxhetin 2023/25;
- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve për mbajtjen e mbledhjes së KKSBB-së;
- Dalje në terren me qëllim përcjelljen e të gjitha punëve dhe aktiviteteve që zhvillohen në komunë;

Tetor

- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal;
- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komitetit për Komunitete;
- Pjesëmarrja dhe informimi lidhur me mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve;
- Pjesëmarrja në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës si brenda dhe jashtë Komunës, si dhe publikimi i vendimeve të nënshkruara nga Kryetari;
- Pjesëmarrja, njoftimi dhe publikimi i aktiviteteve nga festa tradicionale “Dita e Gështenjës”;
- Dalje në terren me qëllim përcjelljen e të gjitha punëve dhe aktiviteteve që zhvillohen në komunë;

Nëntor

- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal;

- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komitetit për Komunitete;
- Pjesëmarrja dhe informimi lidhur me mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve;
- Pjesëmarrja në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës si brenda dhe jashtë Komunës, si dhe publikimi i vendimeve të nënshkruara nga Kryetari;
- Percjellja e organizimeve me rastin e 28 Nëntorit;
- Dalje në terren me qëllim të përcjelljes dhe informimin me të gjitha punët që po zhvillohen në komunën tonë;

Dhjetor

- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Kuvendit Komunal;
- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve dhe lajmeve për mbajtjen e mbledhjeve të Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF) dhe Komitetit për Komunitete;
- Pjesëmarrja dhe informimi lidhur me mbledhjet e Këshillit të Drejtorëve;
- Pjesëmarrja në takimet e drejtpërdrejta të Kryetarit të Komunës si brenda dhe jashtë Komunës, si dhe publikimi i vendimeve të nënshkruara nga Kryetari;
- Pjesëmarrja, njoftimi dhe publikimi i aktiviteteve nga fushata sensibilizuese “16 Ditë Aktivizëm për Eliminimin e Dhunës ndaj Gruas”;
- Pjesëmarrja dhe publikimi i njoftimeve për mbajtjen e mbledhjes së KKS-së;
- Pjesëmarrja, njoftimi dhe publikimi i takimit të dytë publik me qytetarë i Kryetarit, z. Bashkim Ramosaj;
- Dalje në terren-fotografimi i viseve malore me qëllim të promovimit të turizmit dhe atraksioneve që ofron Deçani.

➤ Zyra e Prokurimit

RAPORTI VJETOR PËR KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE

Konform me art. 87.2.12 të Ligjit të Prokurimit Publik Nr. 041-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 041-237, ligjin Nr. 051-068 dhe ligjin Nr. 051-092

Data e përgatitjes së raportit: 25.01.2022

Viti fiskal : 2021

PJESA I. IDENTIFIKIMI I AUTORITETIT KONTRAKTUES

Emri zyrtar i Autoritetit Kontraktues	Komuna e Deçanit		
Lloji i Autoritetit Kontraktues (shtjdhënë njëjten)	Kompani Publike		
Kodi buxhetor	631		
Adresa	Sheshi "Mentor Tolaj" Objekti I Kuvendit Komunal, Deçan		
Kodi postar - Qyteti	51000		
Tel, fiks/ Celulari /Faksi	03820044333, 044178837		
Emri i menxherit të prokurimit	Xhevdet Ramosaj		
E-mail adresa	prokurimi.decan@rks-qov.net		
Adresa e webit të AK	http://kk.rks-qov.net/decan/Prokurimi/Noftim-per-kontrate.aspx		

PJESA II. KONTRATAT E NËNSHKRUARA PUBLIKE

Lloji i Buxhetit	Nr. i Prokurimit	Lloji i Prokurimit	Vlera e Prokurimit	Procedura e Prokurimit	Klasifikimi (2 shifra të para të PPP)	Titulli i aktivitetit të prokurimit	Data e inicimit të aktivitetit të prokurimit	Data e publikimit të njoftimit për kontratë	Data e publikimit të njoftimit për dhënien e kontratës	Data e nënshkrimit të kontratës (në rast anulimi data e njoftimit për anulim)	Afate për implementimin e kontratës (shkruaj datën e fillimit dhe të përfundimit)	Data e përmbylljes së kontratës (data e pranimit të përkohshme/përfundimtar)	Vlera e parashkuar e kontratës	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat e tj.	Çmimi i kontratës, duke përfshirë të gjitha taksat e tj.	Zbritjet nga kontrata për shkak të ndalesave	Çmimi total i paguar për kontratën	Emri i OE që është dhënë kontratës	OE vendar (2)		Numri i kërkesave për DT dhe numri i ofertave që dorëzuan	Numri i ofertave të refuzuara (shëruaj vetëm ato me emërin më të ulët në krahasim me të tjerët)	Afati kohor normal (3)	Afati kohor i shkurtuar (2)	Çmimi më i ulët (3)	Kriteret për dhënien e Tenderit ekonomikisht më
																			20	21						
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13	14	15	16	17	18.00	19	20	21	22	23	24			
2	001	2	3	6	93	Zerimi për manifestime të ndryshme në Deçan	10.03.2022	10.03.2022	28.03.2022	01.04.2022	01.04.2023	01.04.2023	€ 9,900.00	€ 9,800.00	€ 9,800.00	€ 18.00	N.S.H. "JONI"	1	8	1	1	1	1			
2	002	5	2	1	45	Meremetimi dhe inventarizimi i objekteve shëtitore alpine bishkate	15.03.2022	21.03.2022	21.03.2022	06.05.2022	06.05.2025	06.05.2025	€ 387,727.00	€ 386,224.25	€ 386,224.25	€ 9,800.00	SINANI - ING SH.P.K.; J.L	1	40	3	2	1	1			
2	003	1	2	1	21	Furnizim me material zyrtar për institucionet publike të	25.03.2022	28.03.2022	19.04.2022	21.04.2022	21.04.2025	21.04.2025	€ 120,000.00	€ 120,000.00	€ 120,000.00	€ 115,000.00	N.T. "Agimi-De"	1	20	1	1	1	1			
2	004	1	4	7	28	Furnizimi dhe montimi i mbrojtësve të borës	04.04.2022	N/A	N/A	12.12.2022	12.04.2022	12.04.2022	€ 999.9	€ 999.60	€ 999.60	€ 999.60	Arton Ramosaj B.I.(N.S.	1	3	1	1	1	1			
2	005	1	4	7	28	urnizimi me pajisje elektrike për shëtitore dhe komunitetit në Deçan	27.05.2022	N/A	N/A	08.06.2022	20.06.2022	20.06.2022	€ 982.00	€ 980.00	€ 980.00	€ 980.00	N.T.S.H. "GIPA "	1	3	1	1	1	1			
2	006	2	3	6	93	Shërbimi me tenda dhe karrika për manifestime	08.04.2022	08.04.2022	04.05.2022	04.05.2022	06.05.2022	06.05.2022	€ 9,900.00	€ 9,163.00	€ 9,163.00	€ 9,700.00	BLEDAR KADRIAJ B.I	1	10	1	1	1	1			
2	007	5	2	1	45	Ndërtimi i fshatit turistik Podi i Geshenjavës	19.04.2022	20.04.2022	25.05.2022	26.05.2022	26.05.2025	26.05.2025	€ 250,000.00	€ 193,320.00	€ 193,320.00	€ 100,000.00	INGconcept SH.P.K.; VB.	1	37	5	4	1	1			
2	008	5	2	5	45	Ndërtimi i shetitores së qytetit-Faza e dytë -PUNË SHITES	20.04.2022	20.04.2022	28.04.2022	29.04.2022	10.05.2022	16.05.2022	€ 19,300.00	€ 19,300.00	€ 19,300.00	€ 19,300.00	ARFA GROUP SH.P.K.; IN	1	1	1	1	1	1			
2	009	5	2	1	45	21.04.2022	04.05.2022	14.06.2022	17.06.2022	17.06.2022	17.06.2025	17.06.2025	€ 172,000.00	€ 90,297.60	€ 90,297.60	€ 65,297.00	NIVA Construction " SH.P.K	1	56	4	3	1	1			
2	010	1	2	1	29	Ndërtimi i qendrës turistike në bashkëfinancim me IPA,G	26.04.2022	06.05.2022	10.06.2022	14.06.2022	17.09.2022	12.08.2022	€ 12,000.00	€ 9,366.90	€ 9,366.90	€ 9,301.90	URANIKU-SG SH.P.K	1	19	6	5	1	1			
2	011	1	2	1	30	Furnizimi dhe montimi i nxehtësive gjendore në QMF Iriqiz	11.10.2022	20.10.2022	31.10.2022	02.11.2022	02.11.2022	14.11.2022	€ 44,000.00	€ 36,447.00	€ 36,447.00	€ 36,447.00	STORM ICT L.L.C. & Safet	1	16	5	4	1	1			
2	012	1	4	7	21	Furnizim me pajisje elektronike	17.05.2022	N/A	N/A	24.05.2022	31.05.2022	31.05.2022	€ 500.00	€ 496.00	€ 496.00	€ 496.00	NTP "Abetare"	1	3	1	1	1	1			
2	013	1	4	7	21	Blerja e mjeteve mësimore për lëndën e biologjisë	17.05.2022	N/A	N/A	23.05.2022	23.05.2022	25.05.2022	€ 999.90	€ 990.00	€ 990.00	€ 990.00	NTP "Abetare"	1	3	1	1	1	1			
2	014	1	3	6	21	Furnizim me material zyrtar për institucionet publike të	19.05.2022	19.05.2022	07.06.2022	10.06.2022	10.07.2022	01.07.2022	€ 5,000.00	€ 4,814.00	€ 4,814.00	€ 4,814.00	" INFINITT " SH.P.K.	1	17	4	3	1	1			
2	015	1	2	1	33	Furnizimi me material medicinal për emergjencën e QK.N	19.05.2022	25.05.2022	27.06.2022	29.06.2022	29.06.2024	29.06.2024	€ 40,000.00	€ 23,239.00	€ 23,239.00	€ 4,343.00	MADEKOS SH.P.K	1	14	4	3	1	1			
2	016	1	2	1	33	Furnizim me material laboratorik	20.05.2022	20.05.2022	27.06.2022	29.06.2022	29.06.2024	29.06.2024	€ 90,000.00	€ 87,827.00	€ 87,827.00	€ 5,734.00	Atom - Med	1	21	1	1	1	1			
2	017	1	2	1	33	Furnizim me material stomatologjik dhe shpenzues për QK.N	20.05.2022	23.05.2022	08.07.2022	15.07.2022	14.07.2024	14.07.2024	€ 40,000.00	€ 19,790.00	€ 19,790.00	€ 2,352.23	NTSH "Koslabor"	1	15	3	2	1	1			
2	018	5	2	1	45	Elektrifikimi i bishkës së Belegut	24.05.2022	24.05.2022	28.06.2022	30.06.2022	30.06.2025	30.06.2025	€ 350,000.00	€ 336,891.64	€ 336,891.64	€ 50,000.00	ELING GROUP SH.P.K.; MC	1	21	2	1	1	1			
2	019	5	2	5	45	Asfaltimi i rrugëve në Deçan-PUNË SHITES	31.05.2022	31.05.2022	07.06.2022	08.06.2022	08.09.2022	12.12.2022	€ 321,107.50	€ 321,107.50	€ 321,107.50	€ 321,107.50	ARFA GROUP SH.P.K.; CA	1	1	1	1	1	1			
2	020	1	2	1	36	Furnizim me inventar për QKMF"Adem Ulku"	07.06.2022	30.08.2022	07.10.2022	10.10.2022	10.12.2022	25.07.2022	€ 25,000.00	€ 21,309.00	€ 21,309.00	€ 21,309.00	N - LARGE SH.P.K.; Mobil	1	37	4	3	1	1			
2	021	5	1	1	45	s gjendore në Deçan(përj Urës së Demës deri tek rruga "E	09.06.2022	20.06.2022	22.07.2022	25.07.2022	25.07.2025	25.07.2025	€ 3,350,279.00	€ 3,343,334.23	€ 3,343,334.23	€ 1,087,000.00	"Lika Trade Sh.p.k.; Lika C	1	49	5	4	1	1			
2	022	2	1	1	93	10.06.2022	22.06.2022	03.08.2022	05.08.2022	04.08.2022	04.08.2025	04.08.2025	€ 1,887,120.00	€ 1,876,165.50	€ 1,876,165.50	€ 1,876,165.50	"Lika Trade Sh.p.k.; Lika C	1	38	4	3	1	1			
2	023	1	2	1	31	Mirëmbajtja verore dhe dimërore e rrugëve në Komun	10.06.2022	24.06.2022	03.08.2022	05.08.2022	04.10.2022	04.10.2022	€ 50,000.00	€ 48,811.00	€ 48,811.00	€ 48,811.00	k "Lika Trade Sh.p.k.; Lika C	1	27	1	1	1	1			
2	024	5	1	1	45	Furnizimi dhe montimi i kamerave në qytet	13.06.2022	14.06.2022	25.07.2022	26.07.2022	26.07.2025	26.07.2025	€ 699,970.00	€ 649,651.70	€ 649,651.70	€ 400,000.00	Cimi @ ELECTRONIC SH.	1	29	1	1	1	1			
2	025	5	2	1	45	Ndërtimi i rrugës në fshatin Pileq	15.06.2022	15.06.2022	01.08.2022	02.08.2022	02.08.2024	02.08.2024	€ 463,731	€ 386,333.71	€ 386,333.71	€ 251,475.15	MIRUSHA COMPANY SH.	1	29	1	1	1	1			
2	026	1	2	1	2	Ndërtimi i objekteve të trashëgimisë kulturore (Kos	17.06.2022	19.07.2022	17.08.2022	22.08.2022	22.08.2023	22.08.2023	€ 170,000.00	€ 169,560.00	€ 169,560.00	€ 169,560.00	HIDRO PROJECT SH.P.K.	1	10	2	1	1	1			
2	027	5	2	1	45	Furnizim me lëndë djegëse(drupet)	21.06.2022	27.06.2022	01.08.2022	05.08.2022	05.08.2025	05.08.2025	€ 498,596.00	€ 487,560.66	€ 487,560.66	€ 50,000.00	" AOME " SH.P.K	1	17	3	2	1	1			
2	028	5	2	1	45	Asfaltimi i rrugëve në Belle-Faza e I	22.06.2022	22.06.2022	06.09.2022	08.09.2022	08.09.2025	08.09.2025	€ 290,000.00	€ 217,991.48	€ 217,991.48	€ 50,000.00	AHMETAJ GROUP SH.P.K	1	17	3	2	1	1			
2	029	5	2	5	45	Ndërtimi i ujësjellësit në Bishkën e Madhe dhe bishkë	22.06.2022	22.06.2022	06.09.2022	01.07.2022	03.10.2022	03.10.2022	€ 32,369.00	€ 32,323.00	€ 32,323.00	€ 32,323.00	MITPROJECT SH.P.K.; D	1	26	6	5	1	1			
2	030	5	2	1	45	Ndërtimi dhe riparimi i Memorialëve të Dëshmorëve-PUN	22.06.2022	22.06.2022	29.06.2022	01.07.2022	03.10.2022	03.10.2022	€ 32,369.00	€ 32,323.00	€ 32,323.00	€ 32,323.00	ENGINEERING GROUP SH	1	3	1	1	1	1			
2	031	2	3	6	55	Asfaltimi i rrugës "Sadriaj" Gramaqel-Deçan	23.06.2022	04.08.2022	15.09.2022	21.09.2022	21.12.2022	14.12.2022	€ 60,000.00	€ 58,046.56	€ 58,046.56	€ 56,630.56	„Menti Sh.p.k.; Engineering	1	15	2	1	1	1			
2	032	1	2	1	33	Transporti dhe qëndrimi në Durrës për stafin	27.06.2022	27.06.2022	13.07.2022	21.07.2022	29.07.2022	30.07.2022	€ 3,000.00	€ 2,670.00	€ 2,670.00	€ 2,670.00	JONI TRAVEL " SH.P.K.	1	14	4	3	1	1			
2	033	5	2	1	45	Furnizim me pajisje mjekësore	27.06.2022	28.06.2022	08.08.2022	10.08.2022	10.10.2022	07.09.2022	€ 12,633.00	€ 11,969.00	€ 11,969.00	€ 11,969.00	PRO MEDICAL SH.P.K.	1	22	4	3	1	1			
2	034	5	2	1	45	Ndërtimi dhe asfaltimi i rrugës Sadri dhe Adem Osaj(Gus	28.06.2022	04.07.2022	17.10.2022	18.10.2022	18.10.2025	18.10.2025	€ 477,133.00	€ 474,225.17	€ 474,225.17	€ 31,703.00	Lika Company SH.P.K.; „L	1	32	6	5	1	1			
2	035	2	1	1	45	Ndërtimi i qendrës turistike në bashkëfinancim me IPA.C	14.07.2022	14.07.2022	16.08.2022	18.08.2022	21.08.2024	21.08.2024	€ 100,755.00	€ 88,838.00	€ 88,838.00	€ 31,703.00	" HIDRO PROJECT " SH.P	1	32	4	3	1	1			
2	036	1	4	7	21	Shërbime te Energjisë sipas UDHEZIM ADMINISTRAT	12.07.2022	02.08.2022	05.09.2022	09.11.2022	09.11.2025	09.11.2025	€ 1,897,000.00	€ 1,897,000.00	€ 1,897,000.00	€ 1,897,000.00	JAVNA RAZSVETLJAVJA d	1	29	1	1	1	1			
2	037	5	2	5	45	Blerja e mjeteve mësimore për lëndën e biologjisë	02.08.2022	N/A	N/A	15.08.2022	25.08.2022	26.08.2022	€ 1,000.00	€ 990.00	€ 990.00	€ 990.00	NTP "Abetare"	1	3	1	1	1	1			
2	038	5	2	5	45	Ndërtimi i Qendrës Rinore në Deçan - PUNË SHITES	29.08.2022	29.08.2022																		

➤ Zyra e Auditorit të Brendshëm

Njësia e Auditimit të Brendshëm është pjesë e Administratës së Komunës së Deçanit në kuadër të zyrës së Kryetarit, pra NJAB i ushtron kompetencat e veta në përputhje me Ligjin nr. 06/L-121 për Kontroll të Brendshëm të Financave Publike.

Njësia e Auditimit të Brendshëm në përmbushjen e detyrave të saj është llogaridhënës ndaj Kryetarit të Komunës, Komitetit të Auditimit dhe Njesisë Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm (NJQHAB), në kuadër të Ministrisë së Financave dhe Transfereve.

Qëllimi i Njesisë së Auditimit të Brendshëm është të ofroi shërbime të pavarura, objektive, siguroese dhe këshillëdhënëse të dizajnuara që të shtoj vlerën dhe të përmirësoj operacionet e organizatës. Ai ndihmon organizatën që të arrijë objektivat e saja duke sjell një qasje sistematike dhe të disiplinuar për të vlerësuar dhe përmirësuar efektivitetin e proceseve të menaxhimit të rrezikut, kontrollit dhe qeverisjes.

Drejtori i NJAB-ës dhe Auditori i Brendshëm kanë përgjegjësinë që të:

Dorëzoj Planin Strategjik dhe Vjetor të Auditimit të Brendshëm tek NJQHAB-ja, jo më vonë se deri më 31 dhjetor të secilit vit kalendarik pas miratimit nga menaxhmenti i lartë (Kryetari i Komunës) dhe komiteti i Auditimit. Duke u bazuar në planin vjetor të NJAB-së për vitin 2022 kanë qenë të planifikuara 5 auditime të rregullta dhe po ashtu janë kryer të pestat që do të thotë është përmbushur plani vjetor. Gjithashtu janë përpiluar dy raporte gjashtëmujore si dhe raporti vjetor i punës të cilat janë dorëzuar tek Kryetari i Komunës dhe në Njësinë Qendrore Harmonizuese – Ministria e Financave dhe Transfereve. Janë përpiluar Plani Strategjik 2023-2025 dhe Plan Vjetor 2023 ku janë shqyrtuar dhe aprovuar nga Komiteti i Auditimit dhe Kryetari i Komunës dhe dorëzuar po ashtu në Njësinë Qendrore Harmonizuese – Ministria e Financave dhe Transfereve. Sa i përket Komitetit të Auditimit kanë mbajtur pesë takime të rregullta ku kanë dalur me rekomandime për menaxhmentin e Komunës.

Përgatitja dhe zbatimi i planit vjetor të auditimit të brendshëm						
3.23 Gjithsej numri i auditimeve të planifikuara me plan vjetor sipas periudhave raportuese dhe realizimi i tij (për të cilat janë përpiluar raportet finale)						
Periudha raportuese	Numri i auditimeve të planifikuara	Ditët e planifikuara për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të planifikuar për angazhim	Numri i auditimeve të kryera	Koha e shpenzuar për kryerjen e auditimit	Numri i auditorëve të angazhuar për auditim
Gjashtëmujori I	3	90	2	3	91	2
Gjashtëmujori II	2	60	2	2	64	2
Vjetore	5	150	2	5	155	2

Numri i rekomandimeve në raportet e auditimit/planet e veprimit dhe numri i rekomandimeve të zbatuara në periudhën raportuese:	
3.34 Numri i rekomandimeve të dhëna në raportet e auditimit:	41
3.35 Numri i rekomandimeve të zbatuara:	19
3.36 Numri i rekomandimeve në proces:	11
3.37 Numri i rekomandimeve të pazbatuara:	11
3.38 Nëse ekzistojnë rekomandime të pazbatuara thekso arsyet e moszbatimit:	
Disa nga rekomandimet kërkojnë kohë për implementim ndërsa rekomandimet e gjashtëmujorit të dytë ende nuk kemi mundur t'i përcjellim para përfundimit të vitit 2022.	
Të gjitha auditimet e kryera në periudhën raportuese janë:	

1. Emërtimi i auditimit: Buxhet dhe Financa - Shpenzimet nga kategoria e subvencioneve dhe donacioneve për vitin 2021
2. Emërtimi i auditimit: Shërbime publike - Menaxhimi i kontratave
3. Emërtimi i auditimit: Buxhet – Financa - Të Hyrat dhe Shpenzimet nga të gjitha kategoritë Ekonomike
4. Emërtimi i auditimit: Rishikimi i proceseve të prokurimit Janar-Shtator 2022
5. Emërtimi i auditimit: Menaxhimi i pasurisë financiare dhe jo financiare për periudhën Janar – Dhjetor 2021 dhe TM1/2022

➤ **Drejtoria e Administratës**

Duke u bazuar në planifikimet vjetore të angazhimeve në kuadër të përgjegjësi që ushtron drejtoria për Administratë, rezulton se në vitin 2022 me sukses janë kryer të gjitha obligimet e shërbimeve dhe kërkesave ndaj qytetarëve.

Gjatë gjithë vitit shërbimet e administratës kanë funksionuar mirë, pa ndërprerje dhe me efikasitet janë realizuar të gjitha kërkesat e qytetarëve.

Vlen të theksohet se edhe gjatë muajve të verës – fluksit të pushimeve të bashkatdhetarëve dhe festave të fundvitit nuk ka mbetur asnjë palë pa e marr shërbimin e kërkuar.

Drejtoria për Administratë të përgjithshme pranë Komunës së Deçanit funksionon përmes sektorëve të ndryshëm:

- Sektori i qendrës për shërbim me qytetarë;
- Zyra ligjore;
- Zyrat e gjendjes civile (Deçan, Irzniq, Dranoc dhe Strellc i Epërm);
- Zyra për teknologji informative;
- Zyra për përkthime;

- Shërbimi i rojave të objekteve komunale;
- Shtëpiaku;

Te gjithë sektorët dhe zyrat veç e veç kanë funksionuar mirë në kuadër të përgjegjësive të tyre.

- Gjatë vitit 2022 në zyrën për shërbim me qytetarë (zyrën pritëse) janë pranuar dhe proceduar për realizim 45,049 kërkesa dhe lëndë të ndryshme sipas kodeve të drejtorive komunale.
- Në sektorin e gjendjes civile gjegjësisht në të gjitha zyrat e gjendjeve civile, janë lëshuar 44,907 certifikata të llojeve të ndryshme nga këto:
 - Për përdorim të brendshëm 20,512;
 - Për përdorim të jashtëm 24,395;
- Zyra ligjore ka kryer 240 aktvendime, 29 aktvendime për fitim të shtetësisë, 101 aktvendime për lirim të shtetësisë dhe 5 vërtetime të gjendjes. Zyra ligjore ka komunikuar rregullisht me Agjensionin e regjistrimit civil (A R C).

Duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 01/2022, Çertifikatat për përdorim të brendshëm lëshohen në letër të bardhë të formatit A4, ndërsa për përdorim të jashtëm lëshohen certifikata origjinale me logo të Qeverisë.

Gjithashtu duke u bazuar në Udhëzimin Administrativ në fjalë dhe Memorandumin të dy Ministrive, asaj të Punëve të Brendshme dhe Ministrisë së Drejtësisë për heqjen nga Gjendja Civile Aktin e Vdekjes. Ministria e Drejtësisë deri më tani nuk e ka marrë si kompetencë, prandaj jemi detyruar që me vendim të Drejtorisë si punë shtesë ti bartet zyrtarit Kreshik Dacaj, punëtor i Qendrës për Shërbim me Qytetarë.

- Zyra për Teknologji Informative është kujdesur për mirëmbajtjen e të gjitha pajisjeve elektronike, softuerëve, harduerëve si dhe aplikacioneve të ndryshme. Gjithashtu është kujdesur për funksionimin e kamerës tre dimensionale për përcjelljen e të gjitha seancave të Kuvendit nga Monitoruesit e Ministrisë.
Kjo Zyrë në bashkëpunim me Zyrën e Prokurimit kanë përgaditur dhe specifikuar tenderin për furnizim me pajisje të Teknologjisë Informative të të gjithë sektorëve veç e veç. Po ashtu përmes kësaj zyre është bërë liferimi nëpër sektor sipas kërkesave.
Nga këto pajisje është furnizuar me dy kompjuter Zyra e Gjendjes Civile në Strellc të Epërm.
- Shtëpiaku është kujdesur për mirëmbajtjen e avarive të ndryshme brenda objektit të komunës, ngrohtores, gjeneratorit dhe hapësirave gjelbëruese përreth objektit të komunës.

- Shërbimi i Rojeve ka kryer detyrat e veta në kuadër të përgjegjësisë për ruajtjen e objekteve komunale si dhe funksionimin e portës hyrëse të oborrit të komunës.

Gjatë vitit 2022 si drejtori kemi proceduar në Kuvend për miratim Rregulloren Komunale për organizimin, funksionimin dhe bashkëpunimin e komunave me fshatrat, vendbanimet dhe lagjet urbane. Kjo Rregullore është miratuar në mënyrë unanime nga anëtarët e Kuvendit si dhe kemi pranuar ligjshmërinë nga niveli qendror.

Duke u bazuar në planifikimet nga kategoria mallra dhe shërbime, jemi kujdesur që në çdo sektor të mos ketë ngecje në funksionim.

Sikurse edhe viteve paraprake edhe në vitin 2022 nuk kemi pas asnjë ankesë apo afer korruptive të asnjë zyrtari dhe me sukses janë kryer të gjitha kërkesat e qytetarëve.

Në pjesën narrative të këtij raporti në formë të përgjithësuar këto ishin punët e kryera nga Drejtoria për Administratë të Përgjithshme.

➤ **Drejtoria për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit**

Stafi i drejtorisë për Urbanizëm, Planifikim Hapësinor dhe Mbrojtje të Mjedisit gjatë vitit 2022 i ka menaxhuar dhe kryer këto punë:

- Kryerja e punëve rreth dhënies së kushteve të lokacionit, për ndërtimet e objekteve të reja, adaptimet, rekonstruimet, rindërtimet etj. Janë punuar 13 akte për kushte ndërtim dhe 3 janë në procedurë;
- Kryerja e punëve rreth dhënies së lejes së ndërtimit (llogaritja e taksave urbanistike dhe atyre mjedisore). Janë punuar 13 akte të llogaritjes për leje ndërtimi, 3 akte të taksave të lejeve mjedisore, 6 akte për taksa për shndërrimin e tokës bujqësore në tokë ndërtimore;
- Pritja e palëve dhe informimi rreth procesit të legalizimit të ndërtimeve pa leje;
- Shqyrtimi i lëndëve për legalizimin e ndërtimeve pa leje;
- Legalizimi i ndërtimeve pa leje për 70 objekte dhe vendosja në listën e pritjes për 14 objekte;
- Menaxhimi i Planit Zhvillimor Komunal;
- Menaxhimi i Hartave Zonale;
- Bashkëpunimi me Institutin e Planifikimit Hapësinor në MMPH dhe I, për përpilimin e zonave zhvillimore në kuadër të Parkut Kombëtar “Bjeshkët e Nemuna”;
- Është dorëzuar drafti dhe pritët pëlqimi për diskutim publik nga MMPH për Hartimin e Planit Zhvillimor Komunal;

- Puna në komisione vlerësuese për projekte të ndryshme në zyrën e prokurimit;
- Puna në punimin e paramasave dhe parallogarive për projekte të ndryshme ku investitor është komuna ose KFOR;
- Puna në pranimet teknike të projekteve ku investitor është Komuna dhe Ministria;
- Puna në futjen dhe përditësimin e të dhënave për numra dhe adresim për komunën;
- Përpilimi i kërkesave për Ministritë, Ndërmarrje, Korporata, Agjencione të ndryshme për nxjerrjen e buxheteve dhe përkrahjeve ligjore për projekte të ndryshme;
- Organizimi i 7 takimeve, debate me qytetarë për PLVM;
- Angazhimi në vendosjen e antenës së kompanisë Vala në bjeshkën e Deçanit;
- Angazhimi në hartimin e projektit të elektrifikimit të fshatit Strellc i Ri, elektrifikimin e Qendrës Turistike Bjeshka e Belegut Hartuar dhe elektrifikimi i fshatit turistik “Shkëlzen Haradinaj” nga inxhinierët e Korporatës KEDS;
- Angazhimi në hartimin e projektit të rrugës së Qendrës – Loti II;
- Punimi i projekteve konkurruese në institucionet qendrore për fitimin e garanteve qeveritare;
- Është zhvilluar konkursi i projektimit dhe janë kryer procedurat për përzgjedhjen e kompanisë fituese për ndërtimin e qendrës së qytetit;
- Është punuar Planin Lokal i Veprimit në Mjedis 2022-2027;
- Është punuar në evidentimin dhe regjistrimin e pasurive komunale;
- Pritja e palëve me tematika të ndryshme dhe informimi dhe zgjidhja e çështjeve të natyrave të ndryshme;
- Shqyrtimi i kërkesave dhe kthimi i përgjigjeve;
- Takime me përfaqësues të KFOR –it;
- Takime me përfaqësues të OSBE –së;
- Kryerja e detyrave të ndryshme të dhëna nga drejtori dhe Kryetari i Komunës;

Janë punuar:

- **13** Leje të Ndërtimit për Objekte afariste dhe banesore;
- **4** Leje Mjedisore;
- **8** Pëlqime të natyrave të ndryshme;
- **1** Vendim për Leje Rrëtimi;
- **3** Vendime për Refuzim;
- **8** Njoftime të natyrave të ndryshme;
- **7** Kërkesa për shndërrim të tokës;

- 5 Vendime për emërim të Komisionit për Pranim Teknik;
- 1 Referencë për punë të kryera;
- 25 Përgjigje të kërkesave të ndryshme;
- 0 Vërtetime;
- 70 Vendime për dhënie të certifikatës së legalizimit;
- 14 Vendime për përfshirjen në listë të pritjes për legalizim;
- Janë prezantuar përgjigjet e lëndëve në Intranet;

Mbikëqyrja e punimeve nga stafi i drejtorisë për Projektet:

1. Rregullimi i shtratit të Lumit Lumbardh në Deçan

Punimet vazhdojnë, janë përfunduar mbi 65% të punëve.

2. Hartimi i Hartës Zonale të Komunës së Deçanit

Është punuar drafti final për Hartat Zonale dhe Plani Zhvillimor Komunal është dorëzuar dhe pritët aprovimi i MMPH për diskutim publik.

3. Ndërtimi dhe riparimi i Memorialëve të Dëshmorëve

Vlera totale e kontratës: 323,743.86€

Datë 08.10.2019

Ka përfunduar projekti.

4. Ndërtimi i pendës për ujitje në fshatin Vranoc

Vlera totale e kontratës: 131.118,75€

Datë 17.06.2021

Ka përfunduar projekti.

5. Ndërtimi i shtratit të lumit në Irzniq në lagjen Berisha, Mushkolaj dhe Dodaj në Deçan

Vlera totale e kontratës: 57,868.63€

Datë 08.01.2021

Ka përfunduar projekti.

6. Furnizimi dhe montimi i nxemjes qendrore në QMF Irzniq

Vlera totale e kontratës: 9,366.90€

Datë 14.06.2022

Ka përfunduar projekti.

7. Ndërtimi i fshatit turistik “Podi i Gështenjave”

Vlera totale e kontratës: 193,320.00€

Datë 26.05.2022

Ka përfunduar ndërtimi i 4 shtëpizave.

Projekti është në vazhdim.

8. Asfaltimi i rrugës “Sadrijaj” në Gramaçel

Vlera totale e kontratës 58,046.56€

Datë 21.09.2022

Ka përfunduar projekti.

9. Ndërtimi i qendrës turistike në bashkëfinancim me IPA, GIZ dhe EU – faza e I

Vlera totale e kontratës 90,297.60€

Janë kryer rreth 72% të punimeve.

10. Ndërtimi i qendrës turistike në bashkëfinancim me IPA, GIZ dhe EU – faza e II

Vlera totale e kontratës 88,838.00€

Datë 18.08.2022

Janë kryer rreth 36% të punimeve.

11. Elektrifikimi i Bjeshkës së Belegut

Vlera totale e kontratës 336,914.35€

Datë 30.06.2022

Janë kryer rreth 9% të punimeve.

12. Meremetimi dhe inventarizimi i objektit Shtëpia Alpine Bjeshkatare “Shkëlzen Haradinaj”

Vlera totale e kontratës 386,224.25€

Janë kryer rreth 25% të punimeve.

13. Ndërtimi dhe rikonstruimi i lapidareve në Komunën e Deçanit

Vlera totale e kontratës 246,741.21€

Datë 26.10.2022

Janë kryer rreth 12% të punimeve.

➤ **Drejtoria për Buxhet dhe Financa**

Raporti i punës për vitin 2022 i Drejtorisë për Buxhet dhe Financa është në harmoni të plotë me planet e punës së Qeverisë Komunale, duke pasur parasysh respektimin e plotë të Ligjeve dhe rregulloreve që e rregullojnë punën mjaft delikate të kësaj drejtorie.

Qëllimi i këtij raporti është që të raportohet për mënyrën e ekzekutimit të buxhetit komunal gjatë periudhës **Janar – Dhjetor 2022**.

Në këtë Raport gjithashtu do të paraqitet mënyra e realizimit të buxhetit komunal sipas kategorive ekonomike të shpenzimeve si dhe programeve buxhetore komunale.

Të dhënat e raportit, për shpenzimet operative, investimeve kapitale si dhe të dhënat mbi numrin e punëtorëve dhe shumës për Paga dhe Meditje janë të harmonizuara me Departamentin e Thesarit-MFPT-së.

Ne, gjatë përgatitjes së këtij raporti me përkushtim të madh, saktësi dhe në detaje e kemi paraqitur realizimin e buxhetit komunal për këtë periudhë raportuese.

Drejtoria për Buxhet dhe Financa funksionon në dy sektore:

1. Sektori i Buxhetit dhe financave ku është e inkuadruar edhe zyra e të hyrave dhe
2. Sektori i Tatimit në Pronë.

Tabela 2: Pranimet		DREJTORIA PËR BUXHET DHE FINANCA											
Vlerat janë në Euro.													
Viti	Viti / Muaji	Gjithsej Pranimet	Tatimi në pronë	Taksa rrugore për automjete	Taksa për certifikata dhe dokumente	Participimet dhe donacionet	Qiraja nga objektet publike	Participime në Bujqësi	Participim në Shëndetësi	Participim në Arsime	Të hyra tjera	Gjobat e gjykatave	Gjobat e trafikut
2022	2022 Janar	61,838	29,368	6,139	2,994	0	163	0	70	0	12,339	935	9,831
	2022 Shkurt	54,470	26,681	5,118	2,635	0	163	0	292	0	6,477	1,185	11,920
	2022 Mars	95,230	57,206	5,888	3,121	0	163	0	484	0	14,589	685	13,095
	2022 Prill	78,850	49,598	5,070	3,225	0	163	0	492	0	7,872	1,417	11,015
	2022 Maj	63,330	27,951	5,812	3,491	0	1,183	4	305	0	12,723	1,350	10,512
	2022 Qershor	56,130	19,251	8,020	2,831	0	2,499	343	353	0	8,540	1,790	12,505
	2022 Korrik	63,351	25,133	8,420	3,812	0	355	35	383	0	12,139	200	12,875
	2022 Gusht	129,413	56,852	9,150	5,639	0	2,519	48	876	0	36,949	700	16,680
	2022 Shtator	69,869	30,059	6,891	3,345	0	707	4	366	0	14,785	650	13,063
	2022 Tetor	41,854	21,204	6,350	3,474	0	857	54	321	0	9,596	0	0
	2022 Nëntor	49,998	17,529	6,665	2,538	0	957	321	550	0	21,439	0	0
	2022 Dhjetor	45,856	26,600	7,319	3,379	0	325	0	739	0	7,494	0	0
	Gjithsej 2022	810,189	387,433	80,842	40,482	0	10,049	808	5,230	0	164,940	8,912	111,495

1. Zotimi i Mjeteve Për Vitin 2022

- Regjistrimi i të gjitha pagesave në SIMFK nga të gjitha kategoritë buxhetore, mallra shërbime, kapitale, subvencione dhe komunalit në kodet ekonomike përkatëse, siç është e paraparë me ligjet dhe rregulloret në fuqi.
- Kemi bërë zotimin e mjeteve të të gjitha kategorive ekonomike, mallra dhe shërbime kapitale, subvencione dhe komunalit. Totali i të gjitha zotimeve të këtyre kategorive është në vlerën prej **3,480,474.45€**.
- Mallra **899,533.00€** kurse nga të hyrat vetanake **390,063.19€** totali i mallrave **1,289,596.19€**.
- Kapitale - Granti Qeveritar **1,297,000.00€** nga të hyrat vetanake **615,000.00€** totali i kapitaleve **1,912,000.00€**.
- Subvencione - Grant Qeveritar **119,000.00€** kurse nga të hyrat ishin **41,428.26€** totali i subvencioneve **160,428.26€**.
- Komunalit **78,450.00€** po ashtu nga të hyrat e bartura në kategorin e komunalive ishin dhe **40,000.00€** totali i komunalive **118,450.00€**.

2. Buxheti Dhe Shpenzimet

2.1. Shpalosja e Buxhetit për Periudhën Janar – Dhjetor 2022

- Buxheti fillestar i aprovuar në Kuvendin Komunal ishte në shumën prej **9,617,355€** nga Granti Qeveritar dhe **1,031,709€** nga të Hyrat Vetanake të planifikuara për inkasim gjatë vitit 2022. Andaj, përfundimisht buxheti për vitit 2022 është në shumën totale prej **10,649,355.00€**.
- Bartja e të hyrave vetanake të pa shpenzuara gjatë vitit 2021, që janë bartur në vitin 2022 arrinë vlerën 324,433.51€ dhe janë shpërndarë si në vijim:
 - 6,322.20€ - Paga dhe Meditje
 - 217,683.05€ - Mallra dhe Shërbime
 - 428.26€ - Subvencione dhe Transfere
 - 100,000.00€ - Investime Kapitale
- Grantet e donacioneve të Brendshme dhe participimet e qytetarëve janë në shumën prej 17,523.70€.

1.1. Shpenzimet për Periudhën Janar – Dhjetor 2022

Raport i Shpenzimeve për periudhën Janar-Dhjetor 2022

631	16015	16315	16629	16775	16915	17515	18015	19575	47015	48015	65075	66080	73900	75571	75572	85015	92075	Totali
Kategoria Ekonomike	Z.Kryet.	Adminis.	Inspek.	Prokuri.	Z.Kuven.	Buxheti	Sh.Pub.	Z.Kom.	Bujqësi	Ekono.	Kadastr	Urban.	Shëndet.	Sherb.Soci	Sherb.Rezi	Kultu.	Arsimi	
Paga&Meditje	254,675.83	176,186.07	26,189.07	23,192.97	94,826.52	85,296.53	125,695.47	21,553.62	85,230.79	20,803.31	38,931.66	35,720.81	877,717.57	58,313.25	55,849.09	77,052.42	3,777,553.44	5,834,587.41
Mallra&Sherbime	59,008.86	56,999.62	7,970.98	794.35	11,891.50	488,159.67	137,917.80	1,997.75	7,999.77	7,999.74	8,999.23	14,999.32	274,733.52	14,999.76	75,000.00	17,948.26	288,905.67	1,454,325.80
Komunal							78,450.00						31,050.00	6,975.81	7,704.45		31,499.91	155,680.17
Subvencione	54,000.00						64,700.00											118,700.00
Kapitale							1,960,183.76		50,000.00				98,195.40		4,986.80		37,121.00	2,150,485.96
10/GRANT	367,684.69	233,184.69	34,160.05	23,987.32	106,518.02	571,456.20	2,366,947.03	23,551.37	143,230.56	28,803.05	47,930.88	50,720.13	1,281,696.49	80,288.82	143,539.34	95,000.68	4,115,080.02	9,713,779.34

Paga&Meditje																		0.00
Mallra&Sherbime	10,791.00					151,188.58	49,994.50											211,974.08
Subvencione	26,972.00					6,000.00												32,972.00
Kapitale							424,530.34											424,530.34
21/T.H.V	37,763.00	0.00	0.00	0.00	0.00	157,188.58	474,524.84	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	669,476.42

Paga&Meditje													6,322.20					6,322.20
Mallra&Sherbime						176,376.94												176,376.94
Komunal							39,811.32											39,811.32
Subvencione	428.00																	428.00
Kapitale							100,000.00											100,000.00
22/T.H.V	428.00	0.00	0.00	0.00	0.00	176,376.94	139,811.32	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	6,322.20	0.00	0.00	0.00	0.00	322,938.46

Paga													88,396.26		5,607.00			94,003.26
Mallra&Sherbime																	-	0.00
Financimet nga huam	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	88,396.26	0.00	5,607.00	0.00	0.00	94,003.26

Paga																		0.00
Mallra&Sherbime																	1,496.00	1,496.00
Donacion i brendshem	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00	0.00		0.00	1,496.00	1,496.00
Totali	405,875.69	233,184.69	34,160.05	23,987.32	106,518.02	905,021.72	2,981,283.19	23,551.37	143,230.56	28,803.05	47,930.88	50,720.13	1,376,414.95	80,288.82	149,146.34	95,000.68	4,116,576.02	10,801,693.48

Sub.Totali

10,801,693.48€

PARAJA EGATSHME - A VANSET janë 0.00

Deçan, Dt: 31 / 12 / 2022

PAGESAT NGA GRANT+THV (10+21+22)	10,708,194.22
PAGESAT NGA DONACIONET	96,499.26
PARAJA EGATSHME - AVANSET	0.00
Totali	10,801,693.48

PAGA DHE MEDITJE	5,934,912.87
MALLRA DHE SHERBIME	1,844,172.82
SHPENZIME KOMUNAL	195,491.49
SUBVENCIONE DHE	152,100.00
INVESTIMET KAPITALE	2,675,016.30
TOTALI I PAGESAVE	10,801,693.48
AVANSET	0.00
PAGESAT+AVANCE	10,801,693.48

2.2. Planifikimi i Buxhetit për Vitin 2023

Drejtoria për buxhet dhe financa në muajin qershor ka filluar me planifikimin e buxhetit për vitin 2023.

Pas pranimi të Qarkores së parë buxhetore 23/1 me dt. 16.05.2022, kemi filluar edhe takimet buxhetore për Kornizën Afatmesme 2023-2025.

Janë mbajtur 4 Dëgjime Buxhetore:

1. Dëgjim buxhetor me përfaqësues të fshatrave
2. Dëgjim buxhetor me Arsim
3. Dëgjim buxhetor me Shëndetësi
4. Dëgjim buxhetor me qytetarët e komunës së Deçanit

Me 30 Qershor është aprovuar nga Asambleja Komunale Korniza Afatmesme Buxhetore 2023-2025.

Pas lëshimit të Qarkores së dytë buxhetore nga Ministria e Financave 2023/2 me dt. 17.08.2022 së bashku me Ekzekutivin, KPF-në dhe Asamblenë Komunale, kemi filluar me planifikimin detaj të buxhetit të vitit 2023 së bashku me përfaqësues të ndryshëm nga komuniteti i komunës së Deçanit, para së të finalizojmë planifikimin kemi organizuar dhe mbajtur takime buxhetore me:

1. Dëgjim buxhetor me shëndetësi
2. Dëgjim buxhetor me Arsim (është anuluar për shkak të grevave në arsim)
3. Dëgjim buxhetor me përfaqësues të fshatrave
4. Dëgjim buxhetor me Gra
5. Dëgjim buxhetor me artistë, sportistë, njerëz të artit
6. Dëgjim buxhetor me OJQ
7. Dëgjim buxhetor me qytetarët e komunës së Deçanit

Në mbledhjen e Asamblesë Komunale me dt. 30.09.2022 është aprovuar Buxheti i Komunës së Deçanit për vitin 2023 në total:

- Total Buxheti - **12,119,805.00€**
- Grant Qeveritar - **11,021,320.00€** dhe
- Të hyra vetanake - **1,098,485.00€**
- Paga dhe Meditje – **5,800,000.00€**
- Mallra dhe Shërbime – **2,100,000.00€**
- Shpenzime komunale – **200,000.00€**
- Subvencione – **200,000.00€**

- Shpenzime Kapitale – **3,819,805.00€**

3. Çertifikimin/Aprovimin e kuponëve të shpenzimit

Raporti i përgatitur, mbulon vitin fiskal 2022 dhe paraqet informatën e përcaktuar që kanë të bëjnë me realizimin e Çertifikimit e të gjitha shpenzimeve buxhetore të Komunës së Deçanit, duke siguruar që shpenzimi i parasë publike është bërë në pajtim me legjislacionin në fuqi. Realizimi i Çertifikimit të shpenzimeve për vitin 2022, ka arritur vlerën prej **9,407,173.67€**, duke përfshirë çertifikimin në Paga dhe Meditje, Shpenzime Kapitale, Mallra dhe Shërbime, Shpenzime Komunali, Shpenzime nga Subvencione dhe Transfere si dhe Shpenzimet nga të Hyrat.

Raporti i Çertifikimit/Aprovimit të kuponëve të shpenzimit për periudhën Janar – Dhjetor 2022	
Gjithsejtë Çertifikimi i shpenzimeve për vitin 2022 ka arritur vlerën prej 9,407,173.67€	
Janar	426,246.84€
Shkurt	482,241.76€
Mars	748,749.92€
Prill	882,925.78€
Maj	669,510.88€
Qershor	1,002,109.22€
Korrik	670,668.96€
Gusht	395,094.13€
Shtator	1,124,240.80€
Tetor	1,398,240.80€
Nëntor	770,631.02€
Dhjetor	8,980,936.67€

4. Pagesat në Arkë

Pagesat në Arkë bëhen nën vlerën 10 euro dhe përfshijnë pagesat e certifikatave të lindjes, certifikata të vendbanimit, certifikata të vdekjes, certifikata e statusit martesor, certifikata e martesës, certifikata e bashkësisë familjare, certifikata e shtetësisë, ekstrakt i lindjes, vërtetim nga arkiva dhe taksa tjera administrative.

4.1. Raport detajor për gjithë vitin 2022

Raport i fletëpagesave të lëshuara	87.079€
Raport i pagesave të anuluar	2.478€
Mjetet e dorëzuara në arkën kryesore	94.844€
Mjetet e dorëzuara në arkë sipas Kodit Ekonomik	XH.SH-87.482€ G.K-2.623€ S.D-2.537€ S.L-2.186€ SH.D-7€

5. Departamenti i Tatimit në Pronë

- Zyra e Tatimit në Pronë këtë vit ka inkasuar nga tatimi i pronës vlerën prej **387,433.66€** për periudhën Janar-Dhjetor 2022. Kemi bërë shqyrtimin e ankesave të shqyrtuara nga komisioni: **72** ankesa për objekte dhe parcela – dhe janë rregulluar në sistem.
- Kemi pranuar kërkesa dhe kemi bërë përmirësim të vazhdueshëm pranë ZTP. Gjithsej **246** kërkesa dhe **28** kërkesa për parcela, të gjitha të shqyrtuara dhe të rregulluara në sistem PROTAX.
- Në vitin 2022 ishin 91 regjistrime në total, 75 aplikacione të reja dhe 16 verifikime.
- Certifikata (vërtetime) të pagesës nga sistemi për kryerjen e punëve të ndryshme nga qytetarët janë 9,832 vërtetime të ndryshme sipas kërkesave të zyrës së kadastres, nevoja personale, lirim shtetësie, pensione, viza, subvencione, leje pune, tendera, certifikata për tatimpaguesit dhe procedura tjera të korrigjimeve.

➤ Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, veprimtarinë e saj e zhvillon duke u mbështetur në Ligjin për Shëndetësi, Udhëzimit Administrativ, Ligjin për Shërbime Sociale dhe Familjare, Ligjin për Vetëqeverisje Lokale, Statusin e QKMF-së.

Drejtoria për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale gjatë vitit 2022 ka zhvilluar aktivitetet e saj në të gjitha fushat e veprimtarisë me qëllim të rritjes së cilësisë së shërbimeve të kujdesit parësor shëndetësor si dhe mbështetjen e qytetarëve të Komunës së Deçanit në fushën e shërbimeve sociale dhe më gjërë.

Drejtoria ka pranuar takime të përditëshme me qytetarë për t'u njoftuar me procedura dhe shërbime sipas kërkesave të tyre.

Janë zhvilluar takime edhe nga drejtoria së bashku me shumë organizata që kanë ofruar përkrahjen e tyre ndaj DSHMS-së:

AQH


KFORI-Italian

Shtëpia e Sigurtë e Gruas - Pejë

Shoqatën e Gruas “Jeta” - Deçan

Ambasadën Japoneze


DSHMS ka pranuar 154 lëndë, ku:




Specifikimi i detyrave dhe përgjegjësi të DSHMS

Raportim në Asamble Komunale	Mbikëqyrë situatën epidemiologjike në nivel komunal.	Vendos dhe mbledhë bashkë pagesat brenda kornizave të caktuara nga Ministria e Shëndetësisë
Ofrimin e kujdesit shëndetësor parësor në komunë në pajtim me dispozitat ligjore.	Vendosjen e objektivave lokale për kujdesin primar shëndetësor	Vlerësimin e nevojave lokale për shëndetësi primare
Zhvillimin e planit strehimor për territorin e komunës	Koordinon dhe mbikëqyrë punën e QKMF-së, QMF-ve dhe AMF-ve.	Zhvillimin e buxhetit bazuar në nevojat lokale dhe duke respektuar udhëzimet e MSH-së
	Operimin e qendrave për punë sociale dhe qendrave për mirëqenie sociale	

Aktivitetet e Planifikuara





Vizitë në Qendrat
ku udhëheqen nga
DSHMS-ja

QKMF: Takime me Drejtorin e QKMF-së, Koordinatorin e Cilësisë, Shefat e Reparteve, Koordinatorin e SISH-it

Informacionet: Rregullsitë dhe parregullsitë që ndodhin në QKMF ,numri i vizitave mjekësore, furnizimi më

QPS: Takime me Drejtorin e QPS, shefat e sektoreve dhe zyrtarët e kësaj qendre.

Informacionet: Trajtimi i rasteve me asistencë sociale, rastet e dhunës dhe çdo rast tjetër që i përket kësaj qendre.


DSHMS-ja së bashku me QPS ka bërë monitorimin në familjet që kanë nevojë sociale dhe çdo kërkesë që është paraqitur në QPS, DSHMS dhe Zyrën e Kryetarit në bashkëpunim çdo herë është bërë zgjidhja në bazë të kërkesës së qytetarit

SHK: Takime me Drejtoreshën e SHK.


Informacione: Rreth gjendjes së pacientëve që gjenden në këtë Qendër.

Në raste emergjente të pacientëve, Zyra e Kryetarit dhe DSHMS-ja kanë qenë çdo herë në gatishmëri për të ofruar shërbimin e nevojshëm qendrës së SHK

AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR




DSHMS






Shërbimet Sociale



Sherbimet Rezidenciale




Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare

QKMF në Deçan është Institucion Publik Parësor Shëndetësor, i cili si qëllim kryesor ka promovimin, ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullatës përmes sigurimit të shërbimeve shëndetësore cilësore, gjithëpërfshirëse dhe të vazhdueshme për banorët e komunës së Deçanit.


Shërbimet shëndetësore janë të bazuara në konceptin e Mjekësisë Familjare, i cili ka synim që të gjithë banorëve t'u ofrojë shërbime shëndetësore gjithëpërfshirëse dhe efikase, të bazuar në të dhëna shkencore, përmes caktimit të mjekut familjar, i cili do të jetë portë hyrëse për të gjithë kërkuarit e shërbimeve shëndetësore dhe njëherësh pikë referuese për specialistët, konsulentët.

Këto shërbime janë te orientuara në:



KUJDESI PARËSOR SHËNDETËSOR NË KOMUNËN E DEÇANIT

Komuna e Deçanit ofron shërbime të kujdesit parësor shëndetësor për **40.019** banorë të komunës. Këto shërbime ofrohen në kuadër të rrjetit të institucioneve shëndetësore që funksionojnë në qytet dhe viset rurale



Viti 2022 për Kujdesin Parësor Shëndetësor në Komunën e Deçanit krahasuar me vitin 2021 kishte një fluks më të zvogëluar të pacientëve.

Gjatë këtij viti është bërë:

Distribuími i shërbimeve Laboratorike,


Stomatologjike dhe

Vaksinimi në tri QMF-të në Strellc, Isniq dhe Irzniq.


Në këtë vit është bërë furnizimi i rregullt:

- Reagenca për laborator
- Furnizmi me filma të RTG
- Material stomatologjik
- Material higjenik
- Kompletimi i mungesës së listës esenciale për nevojat urgjente
- Është nënshkruar marrëveshja me Spitalin Regjional të Pejës për asgjësimin e materialeve të rrezikshme mjekësore.


Orari në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare:






QENDRAT FUNKSIONALE






SHËRBIMET E OFRUARA JANAR-DHJETOR 2022














Shërbimet Mjekësore në QMF dhe AMF









KATEGORITË E LIRUARA NGA BASHKËPAGESA NË INSTITUCIONE SHËNDETËSORE:

- Imunizimi
- Shtatzënia dhe planifikimi i familjes
- Fëmijët parashkollorë
- Nxënësit dhe studentët
- Invalidët e luftës
- Rastet me asistencë sociale
- Sëmundjet kronike
- Shërbimet emergjente
- Personat e moshuar mbi 65 vjeç
- Personat me aftësi të kufizuara
- Familjet e dëshmorëve
- Familjet e viktimave civile
- Invalidët civil
- Të burgosurit politikë

Gjatë vizitës mjekësore ose pranimi të shërbimeve në njësitë e QKMF-së dhe në terren, për t'u liruar nga bashkëpagesa duhet pasur edhe dokumentin me të cilin deshmohet gjendja e cila liron nga bashkëpagesa (bazuar në Udhëzimin Administrativ 05/2003)

Në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare në bashkëpunim me KFORIN ITALIAN i'u janë ofruar vizita falas pacienteve që kanë probleme kardiake (me zemer) nga Kardiologu i KFORIT ITALIAN Pasquale LA PROVA, i cili duke parë nevojat e pacientëve ka ofruar edhe bashkëpunime tjera së bashku me Qendrën tonë.

NE JEMI TË INTERESUAR T'I DËGJOJME MENDIMET DHE SYGJERIMET TUAJA SI PACIENT!

Për çdo shqetësim tuajin të nderuar qytetar, bisedoni me personelin shëndetësor apo një nga përgjegjësit e institucionit. Përndryshe, mund të leni shënim në kutinë e ankesave që gjendet në institucionin shëndetësor, apo në Drejtorinë për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale. Ju gjithashtu mund të kontaktoni Ministrinë e Shëndetësisë përmes linjës telefonike falas për ankesat e pacientit, në numrin **0800 17777** ose përmes adresës elektronike: **linjafalas@rks-gov.net**

QENDRA PËR PUNË SOCIALE

Shërbimet Sociale dhe Familjare përfshijnë ofrimin e drejtpërdrejtë të përkujdesjes sociale, këshillimit ose në rastet e veçanta, ndihmë materiale për njerëzit në nevojë sociale.

Person në nevojë nënkupton cilindo person që gjendet në territorin e Kosovës, pa marrë parasysh statusin apo vendin e origjinës, i cili ka nevojë për shërbime sociale për shkak:

- se është fëmijë pa përkujdesje prindore
- se është fëmijë me sjellje asocial
- se është delikuent i mitur
- të marrëdhënieve të çrregulluara në familje
- të moshës së shtyer
- të sëmundjes trupore ose aftësive të kufizuara fizike
- të aftësive të kufizuara mendore
- të sëmundjes mendore
- të rrezikut nga shfrytëzimi ose abuzimi
- të dhunës në familje
- të trafikut të qenieve njerëzore
- të varësisë nga alkooli ose drogat
- të emergjencave ose fatkeqësive të shkaktuara nga natyra apo njeriu ose për ndonjë arsye tjetër që i bën ata persona nevojtarë.

Në Komunën e Deçanit në Qendrën për Punë Sociale kryhen këto shërbime:

12

Të miturit në Konflikt me Ligjin-Delikuenca, Anamneza

0

Fëmijët e keqtrajtuar

0

Fëmijët e braktisur, potencial për Adoptim

1	Fëmijët pa përkujdesje prindore me strehim tek të afërmit
12	Fëmijët me aftësi të kufizuara
6	Kujdestaria ndaj fëmijëve
0	Familja Strehuese
2	Mbrojtja e personave të moshuar-vendosja në shtëpinë e pelqve
0	Puna e rrezikshme e të miturve
2	Kërkesë për Adoptim
7	Dhuna në familje
5	Kërkesa për këshilla martesore

0	Familja Strehuese
2	Mbrojtja e personave të moshuar-vendosja në shtëpinë e pelqve
0	Puna e rrezikshme e të miturve
0	Përdoruesit e substancave narkotike
0	Përdoruesit e Alkoolit
2	Martesa e të miturve

30	Vizita në terren
35	Përfaqësim në seanca gjyqësore
9	Kontaktme të zhvilluara me familje dhe fëmijë

72	Vërtetime për aplikim të shlyerjës së shtetësisë së Kosovës
98	Vërtetim për armëmbajtje
25	Çertifikata për aplikim-punësim

▶ 55 **Konstatime, sygjerime, udhëzime të ndryshme**

▶ 3 **Caktimi i kujdestarisë pas marrjes së zotësisë së veprimit nga gjykata**

▶ 12 **Përpilimi i raporteve për shërbimin e SAS-it**

▶ 3 **Anamneza për bashkim familjar**

▶ 9 **Vërtetim për mbajtjen financiare për antarët e familjes nga familjarë që gjenden jashtë shtetit**

▶ 5 **Autorizime për udhëtime jashtë vendit**

▶ 17

Raporte për shkurorëzime

▶ 2

Vendosja e grave me fëmijë në Shtëpinë e Sigurt pas dhunës në familje

▶ 5

Vendosja e grave me fëmijë tek të afërmit pas dhunës në familje

▶ 10

Vizita nëpër shkolla

▶ 8

Aktvendime të ndryshme

▶ 1

Shënime Zyrtare

▶ 20

Raporte për FAKP

▶ 25

Raporte të ndryshme

**RAPORTI I SHËRBIMEVE TË ASISTENCËS SOCIALE PËR VITIN
2022**

317

Numri i familjeve me Asistencë Sociale

101

Vazhdimi i kartonave për ndihma sociale

32

Kërkesa për ndihmë sociale

15

Kërkesa të aprovuara nga Komisioni

101

Replikime

8


Ndërprerja e ndihmave Sociale

5

Kërkesa të refuzuara për ndihmë



Roli i Shtëpisë së Komunitetit në Deçan është i veçantë dhe i domosdoshëm për rrethanat ekzistuese meqenëse një numër i caktuar i personave kanë nevojë për një përkujdesje të vazhdueshme nga institucionet. Aktualisht në shtëpinë e Komunitetit janë 8 pacientë, të cilët kanë përkujdesje të vazhdueshme nga stafi mjekësorë.



Veprimtaritë në SHK:

- Përkujdesja mjekësore
- Pranimi i banorëve të rinjë (që përzgjedhen nga DSHMS ne bashkëpunim me Dr.Nysret Pepaj, Neuropsikiatër, në bazë të shkallës së retardimit)
- Vizitat familjare
- Mirëmbajtja e objektit
- Monitorimi i punës së shtëpisë së Komunitetit
- Rekreacioni i Rezidentëve

Shërbimet ndaj pacientëve:

- Përkujdesja nga stafi i SHK ndaj rezidentëve
 - Shërbimet laboratorike
 - Vaksinat sezonale
 - Kontrolla nga specialistet e ndryshëm sa i përket gjendjes shëndetësore
 - Kontrolla nga Neuropsikiatri
 - Kontrolla nga Psikologu Klinik
 - Sigurimi i barnave të nevojshme

Aktivitetet në SHK:

- Realizimi i projektit për riparimin e nyjeve sanitare
- Servisimi i automjeteve
- Furnizimi me karburante
- Furnizimi me mjete higjienike
- Furnizimi me ushqim
- Monitorimi dhe bashkëpunimi me Ministrinë dhe znj. Ganimete Murseli.

➤ Drejtoria për Arsim

Në komunën tonë ekzistojnë 18 SHFMU (me 4 paralele të ndara) dhe 1 SHML dhe 1 IAAP, gjithsejtë 20 shkolla, me numër të nxënësve afërsisht 5700, me 549 punëtorë (mësimdhënës, staf teknik, stafi udhëheqës dhe administrativ).

Gjatë këtij viti shkollor si Drejtori përveç obligimeve të ndryshme administrative dhe teknike, vazhdimisht si staf i DKA-së jemi përkujdesur për mbarëvajtjen e procesit mësimor në të gjitha shkollat e komunës sonë, njëkohësisht jemi përpjekur t'i ndihmojmë dhe po ashtu t'i monitorojmë drejtoritë, stafin e mësimdhënësve dhe të tjerët në realizimin e detyrave dhe përgjegjësi konform ligjeve në Republikën e Kosovës, gjithmonë me qëllimin që shkollat tona të jenë ambiente komode, të pastërta, dhe të përshtatshme për nxënësit tonë. Vazhdimisht kemi komunikuar me shkollat në terren për organizimin sa më të mirë të procesit mësimor, gjithashtu jemi përkujdesur për furnizimin me material administrativ, higjieniko-sanitar, lëndë djegëse, mjete mësimore dhe furnizim me materiale tjera të nevojshme gjatë këtij viti shkollor.

Janar

Dt.10.01.2022. Sot në shkollat tona, fillon mësimi-periudha e dytë e vitit shkollor 2021/ 2022.

Dt.15.01.2022. DKA, në përkujdesjen e Koordinatorit të Kurrikulës Berthamë z. Malaj - zyrtar, bashkë me zyrtarin z.Ramiz Bajramaj është bërë vlerësimi i dosjeve të mësimdhënësve nga trajnimi i mbajtur në muajin shtator 2021.Vlerësimi është bërë nga Trajnerja e licensuar Mr.sc M. Sejda - Lokaj - në fushën programi fillor dhe kryetrajneri Mr.sc H. Qorraj - në fushën shoqëria dhe mjedisi e fusha tjera.

Dt.21.01.2022. Takim online me MASHT. Ministria Nagavci kërkoi nga DKA që të përcjellim me kujdes zhvillimin e situatës epidemiologjike.

Dt.24.01.2022. Task Forca Komunale mbajti takim me drejtorët e shkollave, drejtorët raportuan për situatën pandemike në shkolla, prezent ishte edhe kryetari i komunës z. Bashkim Ramosaj. DKA furnizoj të gjitha shkollat me maska mbrojtëse për nxënës dhe staf të shkollave, dezinfektues për duar, dezinfektues për dezinfektim të hapësirave të brendshme.

Dt.26.01.2022. DKA, kryetari z.Bashkim Ramosaj dhe nënkryetari z.Sami Cacaj, vizitë në SHFMU “Ardhmëria” në Beleg, në shkollën “Ardhmëria”, ishte bërë në tërësi dixhitalizimi i klasave të kësaj shkolle. Dixhitalizimi me smart TV, lloptop dhe pajisje përcjellëse u mundësua falë kryetarit z. Ramosaj, angazhimit të drejtorit të shkollës U. Hasaj, donatorëve dhe përkrahjes nga DKA .Gjithashtu, u funksionalizua kabineti

i TIK-ut me kompjuter falë bashkatdhetarëve, kabineti i shkencave natyrore Fizikë - Kimi - Biologji, kabineti i shkencave shoqërore si dhe Biblioteka e shkollës është aktivizuar (renovuar).

Shkurt

Dt.01-04.02.2022. DKA, të autorizuarit nga DKA, Shefi i Sektorit të Arsimit z. Xhevat Bozhdaraj, Zyrtari i lartë z.Besart Cacaj, vlerësuan dosjet (raportet e punës-performaca në punë) e drejtorëve të shkollave për vitin 2021.

Dt.01.02.2022. Garat Komunale në Ping Pong, organizuan Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike dhe Sportit në Deçan, në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit e përkrahur edhe nga kryetari z. Bashkim Ramosaj. Ishin 18 ekipe konkurrese pjesëmarrëse, 10 shkolla me ekipe meshkuj dhe 8 shkolla me ekipe femra. Garat u zhvilluan në Palestrën e Edukatës Fizike në SHFMU “Rexhep Kadrija” - Rastavicë. Vendin e parë në të dy kategoritë e zunë nxënësit nga shkolla “Maxhun Çekaj”, vendin e dytë në të dy kategoritë e zunë nxënësit nga shkolla “Isa Boletini”, vendin e tretë e kanë zënë nxënësit nga shkolla “Rexhep Kadrija” (meshkujt).

Dt.02.02.2022. Nxënësit deçanas triumfuan në Garat Regjionale të Ping-Pongut.

Nxënësit nga SHFMU “Maxhun Çekaj” – Irzniq:

- Ekipa meshkujve zunë vendin e PARË,

- Ekipa e femrave zunë vendin e DYTË,

Nxënësit nga SHMT “Tafil Kasumaj” – Deçan:

- Ekipa e meshkujve zunë vendin e DYTË.

Dt.08.02.2022. "DITI SERVIS" me pronar Driton Aliçkaj, shkollës "Maxhun Çekaj" i dhuroj vegla pune për nevojat e shkollës.

Dt.09.02.2022. Në organizim të DKA-së, u shpërndanë certifikatat për drejtorët dhe mësimdhënës të shkollave të mesme të ulëta të komunës sonë, që kanë kryer trajnimin e mësimdhënësve dhe lidhshpirt në MKZP dhe Baza e Mikrobilitit, i cili trajnim u mbajt në Mars - Qershor 2021.

Certifikatat i shpërndau përfaqësuesi nga British Council z Selami Klaiqi bashkë me zyrtarin e DKA-së, z R. Bajramaj.

Dt.09.01.2022. DKA, në kuadër të aktiviteteve të projektit ProCareer 2, takimi i parë i Këshillit Regjional për Orientim në Karrierë: Prezantimi i planit vjetor të projektit – “Zhvillimi i shërbimeve të Orientimit në Karrierë dhe Ndërmarrësisë për të rinj”. Takim regjional: SolidarSuisse, KCDF, DKA-Pejë, DKA-Istog, DKA-Deçan, DKA-Klinë.

Dt.12.02.2022. Në organizim të DKA-së dhe Shoqatës Kosovare të Fizikës u mbajtën garat komunale të Fizikanëve të Rinj 2022 për nxënësit e klasëve të IX, X, XI dhe XII edhe në komunën tonë. Garat u mbajtën në Gjimnazin “Vëllezërit Frashëri” në Deçan.

Nxënësit fitues do ta përfaqësojnë komunën tonë në Garat Republikane që do të mbahen me datën me 27 shkurt 2022. Për mbarëvajtjen e garës u kujdes prof. R. Dobraj.

Nxënësit fitues janë:

- Egzon Idriçaj, klasa IX-të në SHFMU “Ardhmëria” – Beleg

- Enis Gjocaj, klasa X-të në SHMT “Tafil Kasumaj” - Deçan
- Rinesa Selmanaj, klasa XI-të në SHMT “Tafil Kasumaj” - Deçan
- Erjon Hadergjonaj, klasa XII-të në Gjimnazin “Vëllezërit Frashëri” - Deçan
- Endrit Povataj, klasa XII-të në Gjimnazin “Vëllezërit Frashëri” – Deçan.

Dt.12.02.2022. DKA, vazhdon ciklin e trajnimeve për mësimdhënës. Trajnimi dy ditorë, me mësimdhënës dhe koordinatorë të cilësisë, nga shkollat e mesme të ulëta të komunës sonë, me temën "Ngritja e Kapaciteteve të Koordinatorëve për Sigurimin e Cilësisë në fushën e arsimit parafillor". Trajnimi është implementuar nga Education Comes First në Projektin SHPRESE, që mbështetet nga Caritas-i Zvicran në Kosovë.

Dt.19 dhe 20.02.2022. DKA, vazhdon ciklin e trajnimeve për mësimdhënës. Trajnimi tetë ditorë, me mësimdhënës të pashkollorëve nga shkollat fillore të komunës sonë, me temën "Mësimdhënia në parafillor". Trajnimi është implementuar nga Projekti SHPRESE, që mbështetet nga Caritas-i Zvicran (në Kosovë).

Dt.15.02.2022. Në SHFMU "Kuvendi i Verrave të Llukës" projekt për nxënës, nga Federata e Futbollit e Kosovës fillon projektin “Futbolli në shkollë”. Qëllimi i këtij projekti është shtrirja e futbollit në çdo cep të vendit dhe zbulimi i talenteve qysh në moshën e re. Është mbajtur aktiviteti i parë në shkollën tonë nga prof. Rexhep Daci me nxënësit e moshës 9 dhe 10 vjeç.

Dt.16.02.2022. Në prag të festës së 14 vjetorit të Pavarësisë së Kosovës, është bërë përrurimi i objektit të ri të shkollës fillore “Heronjtë e Dukagjinit” në Glllogjan. Të pranishëm ishin kryetari i komunës z. Bashkim Ramosaj, ish kryeministri z. Ramush Haradinaj, zvm z. Dukagjin Popovci (MASHTI), drejtorë të drejtorive të komunës, familjarë të dëshmorëve, prindër, nxënës e qytetarë të tjerë.

Dt.21.2.2022. Nga Deçani në Olimpiadën Matematikore të Kosovës, përfaqësojnë nxënësit fitues:

Klasa e IX

1. Rinor Selmonaj - SHFMU “Rexhep Kadrijaj”
2. Vlora Qufaj - SHFMU “Sylejman Vokshi”

Klasa e X

1. Altin Mulaj - SHMT “Tafil Kasumaj”
2. Enis Gjocaj - SHMT “Tafil Kasumaj”
3. Ali Gashi - Gjimnazi “Vëllezërit Frashëri”

Klasa e XI

1. Rinesa Selmonaj - SHMT “Tafil Kasumaj”
2. Laurent Kadrijaj - SHMT “Tafil Kasumaj”

Klasa e XII

1. Arijon Mazrekaj - Gjimnazi “Vëllezërit Frashëri”
2. Arbi Dobraj - SHMT “Tafil Kasumaj”

Nga DKA, paraqiten dy kërkesa: për KPF (25.02.2022) dhe për Asamblenë Komunale (dt.28.02.2022). Kërkesë, Komisioni për Përzgjedhjen e Drejtorëve të Institucioneve Arsimore në Komunën e Deçanit, kërkesë për ndërrim profili nga SHMT në IAAP “Tafil Kasumaj”.

Dt.28.02.2022. DKA, takim në MASHTI, tema organizimi i procesit mësimor në Kosovë.

Mars

Dt.02.03.2022. Debat, DKA e përfaqësuar nga zyrtarët, ishte pjesë e projektit "Fuqizimi i lidhjeve në mes Shoqërisë Civile dhe Institucioneve Publike për promovimin e sundimit të ligjit në Kosovë", projekt i përkrahur nga Ambasada Amerikane në Kosovë dhe i zbatuar nga organizata HUMAN në partneritet me Radio Peja.

Dt.04.03.2022. Kryetari i komunës z. Bashkim Ramosaj, me përfaqësuesit e Caritas-it Zvicran në Kosovë, nënshkruan marrëveshje për vendosjen e standardeve para-shkollore të cilësisë së lartë duke përfunduar arsimin, shkencën dhe ekonominë. Trajnime për mësimdhënësit e këtij niveli dhe furnizimi i klasës parashkollore në SHFMU "J. Gërvalla" në Prapaqan.

Dt.04.03.2022. Në Garat Republikane të Fizikanëve të Rinj, të mbajtura me dt.27.02.2022 në Prishtinë: nx.nga SHMT "Tafil Kasumaj" - Deçan, Enis Gjocaj, klasa e dhjetë zuri vendin e tretë.

Ndërsa nxënësit: Rinesa Selmonaj klasa e XI-të nga SHMT "Tafil Kasumaj", Erion Hadergjonaj klasa e XII-të dhe Endrit Povataj klasa e XII-të, nga Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri", janë renditur në mesin e dhjetë me të mirëve në nivel vendi.

Dt.05.03.2022. Në shkollat tona, me aktivitete të ndryshme është përkujtuar përvjetori i "Epopesë së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës".

Dt.05.03.2022. Në Prishtinë është zhvilluar OMK 2022, këtë vit garuan dhjetë nxënës nga shkollat tona të përzgjedhur nga Olimpiada e Matematikës në nivel Komunal. DKA dhe Prof. Muharrem Kukalaj janë përkujdesur për nxënësit.

Dt.07.3.2022. Marsi është dita për të kujtuar dhe vlerësuar mësuesit për përkushtimin e tyre në përgatitjen e brezave të ardhshëm. Sot në sallën e Kuvendit Komunal të Deçanit, me organizimin e DKA-së dhe SBASHK (dega në Deçan) është shënuar 7 Marsi, dita e mësuesit, u ndanë mirënjohje për mësimdhënësit e pensionuar nga dt.07.03.2021 deri me dt.07.03.2022. I pranishëm në këtë takim ishte edhe i pari i Komunës së Deçanit z. Bashkim Ramosaj,

Dt.07.03.2022. Në Olimpiadën e Matematikës të Kosovës të mbajtur me 05-03-2022 nga nxënësit e komunës së Deçanit janë këto rezultate, në nivel vendi: Nxënësit e klasës së X-të në SHMT "Tafil Kasumaj", Altin Mulaj dhe Ramë Hadergjonaj kanë zënë vendin e pestë për klasat e X-ta. Ndërsa nxënësi i klasës së IX-të në SHFMU "Rexhep Kadrija" Rinor Selmonaj ka zënë vendin e shtatë për klasat e IX-ta.

Dt.07.03.2022. Me propozim të DKA-së, Profesorit Xhavit Ramosaj mësimdhënës në SHFMU "Bajram Curri", i nominuar nga DKA "Mësimdhënës i vitit", ju nda Mirënjohje nga Ministria e Arsimit, Shkencës, Teknologjisë dhe Inovacionit. Motivacioni i kësaj mirënjohjeje është "Për kontribut të veçantë në fushën e arsimit dhe edukimit". Profi Xhavit ka treguar rezultate të larta me nxënësit e vet në garat sportive në nivel komunal, regional dhe në nivel vendi.

-Organizimi i garës KANGAROO me rreth 30 nxënës në komunën tonë, gara u organizua në SHFMU "L. e Prizrenit" në Deçan nga porf. Sh. Ramosaj, (DKA njofton nxënësit për garën).

Dt.07.03.2022. DKA në bashkëpunim me shkollat bën përgatitjet për testet e: Arritshmerisë, Maturës, TIMSS, PIRLS, ICIS edhe PISA.

Dt.11.03.2022. Janë çertifikuar të gjithë mësimdhënësit që kanë përfunduar trajnimin në muajn Shtator 2021 për Kurrikulë. Në organizim të DKA-së në bashkëpunim me Drejtorin e shkollës "Dëshmorët e Kombit" Phd. can. H. Balaj, para mësimdhënësve të çertifikuar, u mbajt ligjeratë me temën "Informim për komponentën e vlerësimit të nxënësve".

Dt.11.03.2022, Drejtori i DKA-së, priti në takim pune përfaqësues nga Organizata Gjermane GIZ, të udhëhequr nga z Tobias Seiberlich, menaxher i projektit "Fit for Jobs". Temë e takimit ishte: Bashkëpunimi dhe ndihma në përgatitjen e nxënësve për orientim në karrierë dhe

avancimi i shkollës profesionale. Gjatë ditës i vizituan shkollat “Rexhep Kadrijaj” në Rastavicë dhe SHMT “Tafil Kasumaj” në Deçan, ku u pritën nga drejtorët e shkollave z.B. Selmonaj dhe z.L. Stojkaj.

Dt.11.03.2022. SHFMU "Sylë Alaj" Drenoc, me qëllim të ngritjes së cilësisë në fushën "Mësimdhënia dhe nxënia", nën përkujdesjen e drejtorit të shkollës, z.Z. Nitaj dhe arsimtarit të lëndës z. Sylejmon Lokaj është zhvilluar. Kuizi i diturisë në Lëndën e Gjuhës shqipe. Kjo është garë e brendshme në të cilën marrin pjesë nxënësit nga klasat 6,7,8 dhe 9.

Dt.15.03.2022. Drejtori i DKA-së, priti në takim zyrtarët policor nga Stacioni i Policisë në Deçan, z.A. Çeku dhe z. M. Lekaj. Temë e bisedës ishte: Siguria në institucionet shkollore dhe evitimi i dukurive negative, bashkëpunimi vazhdon të jetë i rregullt.

Dt.15.03.2022. SHMT "Tafil Kasumaj", organizohet Trajnim me nxënësit (disa prej tyre) e shkollës në bashkëpunim me GIZ dhe GFA-Zhvillimi i aftësive sociale!

Dt.15.03.2022. Drejtori i DKA-së, priti në takim pune përfaqësuesit nga OJQ "TOKA", ku u bisedua për mundësitë e bashkëpunimit në projekte, që në fokus kanë grup moshat e nxënësve nga shkollat e mesme në komunën tonë. Në takim ishin, zyrtari R. Bajramaj, drejtori nga SHMT "T. Kasumaj" z.L. Stojkaj me prof. F. Kukalaj dhe nga Gjumnazi "V. Frashëri" Prof. R. Dobraj.

Dt.16.03.2022. Trajnim nga MASHTI me mësimdhënës në Deçan. Organizimi i Testit PISA, në dy shkollat e mesme: Pjesëmarrës nxënësit e katër shkollave fillore (mosha nx. 15 vjeçarë): "Dëshmorët e Baballoqit" - Baballoq, "Heronjtë e Dukagjinit" - Gllogjan, "Faik Konica" - Ratish dhe "Maxhun Çekaj" - Irzniq, nxënësit janë përzgjedhur nga MASHTI,

Dt.21.03.2022. 21 Marsi - Dita Botërore e Sindromës Doën, në shkollat tona shenohet kjo ditë me aktivitete të ndryshme. Nxënësit e SHFMU “Lidhja e Prizrenit” marshuan në rrugët e qytetit nën moton “Ec me këpucët e mia”.

Dt.22.03.2022. 22 Marsi- Dita Botërore e Ujit, kjo ditë në shkollat tona shenohet me aktivitete të ndryshme nga nxënësit.

Dt.22.03.2022. U zhvilluan Garat Regjionale në Hendboll (Regjioni Pejë) - në të dy kategoritë – femrat dhe meshkujt. Në bashkëorganizim të SHPKFS në Deçan, me DKA-n dhe përkrahur edhe nga Zyra e Kryetarit Bashkim Ramosaj, të cilat u zhvilluan në palestrën e qytetit. Rezultatet e arritura për shkollat fillore të mesme të ulëta janë:

Femrat: Vendi i parë - SHFMU “Maxhun Çekaj” Deçan

Meshkujt: Vendi i parë - SHFMU “Bajram Curri” Deçan

Ndërsa për SHML në të dy kategoritë fitues u shpallën ekipet nga Gjumnazi “V. Frashëri” Deçan

Dt.23.03.2022. Në nderim të “Epopesë së Dukagjinit”, kemi organizuar aktivitetin sportiv, tashmë tradicional, krosin “Rruga e Lirisë” me nxënësit e shkollave fillore.

Dt.22.03.2022. DKA, Edukatorët në shkollat tona, përfunduan trajnimin nga Projekti SHPRESE me CARITASI-n Zvicran.

Dt.22.03.2022. DKA, Komisioni Parlamentar për Arsim, Shkencë, Teknologji, Inovacion, Kulturë, Rini dhe Sport, dhe Koalicioni i OJQ-ve për Mbrojtjen e Fëmijëve – KOMF organizuan tryezën me temë: “Integrimi i politikave dhe shërbimeve për trajtimin e dhunës ndaj fëmijëve, me fokus në shkollë”. Pjesë e takimit ishte edhe DKA në Deçan.

Dt.25.03.2022. Drejtori i DKA-së priti në takim pune anëtarët e KVPFNV, drejtoreshën B. Tahirukaj - Idrizi, mësimdhënësën F. Molliqaj dhe asistentët që punojnë me fëmijë me NV, Sh. Kuçi, Q. Cacaj dhe F. Dautaj. Temë e takimit ishte puna dhe bashkëpunimi në mes të DKA-së, KVPFNV dhe asistentëve. Në takim ishte edhe zyrtari R. Bajramaj.

Dt.31.03.2022. Nxënësit deçanas triumfojnë në garat Republikane:

Hendboll – meshkujt, “Vëllezërit Frashëri” - Kampion në Republikën e Kosovës.

Hendboll-meshkujt, SHFMU "Bajram Curri" Strellc i Epërm-Kampion në Republikën e Kosovës. Hendboll – vajzat, SHFMU “Maxhun Çekaj”-Vendi i dytë.

Prill

Dt.04.04.2022. Përfundimi i periudhës së dytë në të gjitha shkollat.

DKA, Nxënësit deçanas triumfojnë në garat Republikane:

Hendboll – meshkujt “Vëllezërit Frashëri” - Kampion në Republikën e Kosovës.

Hendboll – meshkujt SHFMU "B. Curri" Strellc i Epërm - Kampion në Republikën e Kosovës.

Hendboll – femrat SHFMU “Maxhun Çekaj” Vendi i dytë.

Dt.05.04.2022. në SHFMU “Esad Mekuli” - Maznik, së shpejti fillojnë punimet në realizimin e projektit për “Eficiencë të Energjisë” në objektin e shkollës.

Dt.13.04.2022. Drejtorja e Arsimit organizoi takim pune me drejtorët e shkollave.

Tema të takimit ishin: -Analizë e suksesit në periudhën e dytë dhe përgatitjet për fillimin e periudhës së tretë, i pranishëm ishte edhe Kryetari i Komunës z Bashkim Ramosaj, më ç’rast i përshëndeti drejtorët, i siguroj ata se jemi bashkë në çdo proces.

Dt.13.04.2022. U zhvilluan garat komunale në futboll - kategoria e femrave. Në bashkëorganizim të SHPKFS në Deçan, me DKA-n dhe përkrahur nga Zyra e Kryetarit z. Bashkim Ramosaj. Garuan 11-të ekipe nga shkollat e mesme të ulëta dhe të mesme të larta.

Fitues nga shkollat e mesme të ulëta ishin:

-Vëndi i parë SHFMU "Faik Konica" - Ratishë

-Vëndi i dytë SHFMU "Lidhja e Prizrenit" - Deçan

-Vëndi i tretë SHFMU "Lan Selimi" - Lumbardh

Ndërsa SHML -Vëndin e parë e zunë vajzat nga Gjumnazi "Vëllezërit Frashëri" - Deçan

Dt.15.04.2022. U zhvilluan garat komunale në futboll - kategoria e meshkujve

Garuan 17 ekipe nga shkollat e mesme të ulëta dhe të mesme të larta.

Fitues nga shkollat e mesme të ulëta ishin:

-Vëndi i parë SHFMU "Bajram Curri" - Strellc i Epërm

-Vëndi i dytë SHFMU "Rexhep Kadrijaj" - Rostovicë

-Vëndi i tretë SHFMU "Dëshmorët e Vokshit" - Pobergjë

Dt.15.04.2022. Drejtori i DKA-së, priti në takim A. Çavolli përfaqësues e IOM-it, A. Lataj përfaqësues i UNMIK-ut. Temë e bisedës ishte gjithpërfshirja e fëmijve të komuniteteve në shkolla dhe bashkëpunimi i vazhdueshëm me këto dy Organizata Ndërkombëtare.

Dita e tokës u shënua në shumë shkolla, me aktivitete të ndryshme.

Dt.22.04.2022. Në kuadër të aktiviteteve ditore të DKA-së, u vizitua SHFMU "Sylë Alaj" në Drenoc, për të përcjellë aktivitetet e nxënësve dhe personelit të kësaj shkolle, të organizuara me rastin e "Ditës së Tokës" (prof. M. Hadërgjonaj) dhe "Ditës Botërore të librit". Së bashku vizitua edhe bibliotekën e kësaj shkolle, e cila është nën përkujdesjen e profit S. Lokaj, kjo bibliotekë ofron mundësi të jashtzakonshme për lexim.

Suksese drejtorit z. Z. Nitaj dhe personelit të shkollës për punën që po bëjnë në vazhdimësi.

Dt.23.04.2022. Drejtori i DKA-së, priti në takim pune përfaqësues të OJQ "ABSM" - Qendra Edukative, z. S. Nikoliqi president dhe K. Rizvanolli koordinatorë të Organizatës. Me ç'rast nënshkruan Memorandumin e bashkëpunimit në mes DKA-së dhe OJQ "ABSM" - Qendra Edukative, dhe u dakorduan për bashkëpunimin në të ardhmën.

Dt.29.04.2022. DKA, Panairi i Praktikës Profesionale, organizuar nga SHMT "Tafil Kasumaj", panair ky i organizuar në kuadër të programit "Java e dyerve të hapura". Qëllimi i këtij panairi është që semimaturantët të kenë mundësinë të shohin nga afër profilet dhe mundësitë praktike të cilat i ofron SHMT "Tafil Kasumaj".

Maj

Dt.04.05.2022. Për nderë të Ditës së Dëshmorëve, Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkëpunim me Drejtorinë për Kulturë, Rini dhe Sport, nën patronatin e Kryetarit të Komunës z. Bashkim Ramosaj, organizuan Festivalin me karakter garues "Vallja Popullore" me nxënës nga shkollat fillore të mesme të ulëta të Komunës së Deçanit. Juria profesionale shpalli fituesit:

Vëndi i parë - grupi i nxënësve nga SHFMU "Lidhja e Prizrenit" - Deçan,

Vëndi i dytë - grupi i nxënësve nga SHFMU "Bajram Curri" - Strellc i Epërm,

Vëndi i tretë - grupi i nxënësve nga SHFMU "Rexhep Kadrijaj" – Rastavicë dhe çmime tjera.

Dt.04.05.2022. DKA, u organizua Ekspozita me punime artistike, me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme të komunës tonë. Ekspozita tashmë tradicionale, organizohet në nderim të datave 5 dhe 6 Maj, si shenjë nderimi dhe përkujtimi për dëshmorët dhe martirët e Kombit!

Dt.08.05.2022. Nxënës nga shkollat tona të mesme kanë zhvilluar vizitë në Prishtinë, 34 nxënës ishin pjesë e këtij aktiviteti, 21 nxënës nga SHMT "Tafil Kasumaj" dhe 13 nxënës nga Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri". Organizimi i këtij aktiviteti ishte bërë nga OJQ "TOKA", ku siguroj transportin e nxënësve, ushqimin, shfaqjen e një filmi në Kinema "ABC", vizitë në zyret e shoqatës dhe realizimin e një aktiviteti në Sheshin "Zahir Pajaziti" në Prishtinë. Në përkujdesje të nxënësve ishte Prof. F. Kukalaj nga SHMT "Tafil Kasumaj".

Dt.17.05.2022. Përfaqësim i suksesshëm i nxënësve nga SHMT "Tafil Kasumaj" në Panairin KOSOVO STEM FAIR. Nxënësit e shkollës tonë morën pjesë në trajnimin dhe panairin KOSOVO STEM FAIR të organizuar për herë të parë në Kosovë. u përzgjidhen 5 nxënës nga shkolla jonë: Rinesa Selmonaj, Dorentina Qufaj, Elvir Bozhdaraj, Leart Kadrijaj dhe Erblin Kasumaj. Trajnimi u mbajt 5 dhe me 13. 05. 2022 nxënësit prezantuan më sukses idetë dhe punimet e tyre. Prezent ishin Drejtori i shkollës L. Stojkaj së bashku me mësimdhënësit: F. Kukalaj dhe I. Lokaj. Në këtë panair vendi i parë dhe i tretë ju takoj nxënësve nga SHMT "Tafil Kasumaj" në Deçan. Nxënësi Elvir Bozhdaraj, vendin e parë. Vendin e tretë Dorentina Qufaj.

Dt.20.05.2022. Drejtoria Komunale e Arsimit në bashkërendim me MASHTI-in, organizoi dy testet ndërkombëtare, TIMSS-me datën 13.05.2022.

Testi PISA u zhvillua me datat 17, 18 dhe 19 maj 2022. Nga shkollat e mesme të larta u testuan 74 nxënës nga klasat e 10-ta dhe 10 nxënës të klasave të 9-ta.

Testi PISA ishte nën përkujdesjen e koordinatorëve të shkollave:

-R. Dobra prof, Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri", Deçan,

- F. Kukalaj prof, SHMT "Tafil Kasumaj", Deçan,
- I. Batusha prof, SHFMU "Dëshmorët e Baballoqit", Baballoq,
- Sh. Mustafaj prof, SHFMU "Heronjtë e Dukagjinit", Gllogjan,
- F. Dabiqaj prof, SHFMU "Maxhun Çekaj", Irzniq,
- A. Kurtaj prof, SHFMU "Faik Konica", Ratish,

(SHFMU-të janë përzgjedhur nga MASHTI). Përgjegjës për org. e testeve TIMSS dhe PISA, ishte koordinatori komunal, nga DKA, Z. Malaj.
Dt.23.05.2022. Në objektin e SHMT "Tafil Kasumaj" në Deçan u mbajtën garat komunale nga lënda e matematikës për nxënësit e klasave VI, VII, VIII dhe IX të komunës sonë. Në gara morën pjesë 84 nxënës të cilët treguan rezultate të mira, por më të dalluarit ishin:

Klasa e VI

1. Elda Lokaj "Dëshmorët e Vokshit" - Pobërgjë
2. Jora Hadergjonaj "Lidhja e Prizrenit" - Deçan
3. Enkela Zeqiraj "Lidhja e Prizrenit" - Deçan

Klasa e VII (Përseritet)

Klasa e VIII

1. Elton Dautaj "Sylejman Vokshi" - Prejlep
2. Yll Tolaj "Sylejman Vokshi" - Prejlep
3. Orgesa Ramosaj "Lidhja e Prizrenit" - Deçan

Klasa e IX

1. Rinor Selmonaj "Rexhep Kadrijaj" - Rastavicë
2. Bliarta Lokaj "Dëshmorët e Vokshit" - Pobërgjë
3. Vlora Qufaj "Sylejman Vokshi" - Prejlep

Dt.27.05.2022. Sot, Kryetari i komunës z. Bashkim Ramosaj, së bashku me zv. Ministren e Arsimit znj. Edona Maloku-Bërdyna, kanë vendosur gurthemeli për ndërtimin e palestrës në SH.M.P "Tafil Kasumaj".

Dt.28.05.2022. Në organizim të DKA-së po mbahet trajnim njëditor me edukatorët e klasave përgatitore. Tema të trajnimit janë:- Zbatimi i kurrikulës në procesin mësimor,- Unifikimi i planprogrameve të nivelit parashkollor - Gjithëpërfshirja e nxënësve dhe tema të rendësisë së veçantë. Trajner, Phd.sc. H. Balaj.

Dt.30.05.2022. Rezultatet e garave komunale nga lënda e Fizikës për nxënësit e klasave VI, VII, VIII dhe IX të komunës sonë. Në gara morën pjesë 93 nxënës, më të dalluarit ishin:

Klasa e VI

1. Rubina Binakaj "Lidhja e Prizrenit" - Deçan
1. Enkela Zeqiraj "Lidhja e Prizrenit" - Deçan
1. Jora Hadergjonaj "Lidhja e Prizrenit" - Deçan
(Pikë të barabarta në vëndin e parë)
2. Dior Sylaj "Ardhmëria" - Beleg
2. Erina Mushkolaj "Lidhja e Prizrenit" – Deçan

(Pikë të barabarta në vendin e dytë)

3. Murtez Tishukaj "Isa Boletini" - Isniq

Klasa VII

1. Teuta Loshaj "Lidhja e Prizrenit" - Deçan

2. Diellza Hulaj "Lidhja e Prizrenit" - Deçan

3. Erdi Shabanhaxhaj "Lidhja e Prizrenit" - Deçan

Klasa e VIII

1. Arsa Bajraktari "Lidhja e Prizrenit" - Deçan

2. Orgesa Ramosaj "Lidhja e Prizrenit" - Deçan

3. Yll Tolaj "Sylejman Vokshi" - Prejlep

Klasa e IX

1. Egzon Idrizaj "Ardhmëria" - Beleg

2. Iurosana Haskaj "Maxhun Çekaj" - Irzniq

Qershor

Dt.01.06.2022. Komuna e Deçanit në bashkëpunim me DKA-në me rastin e 1 Qershorit - Ditës ndërkombëtare të fëmijëve, mbajti program festiv në platon para objektit të komunës

Dt.01.06.2022. në SHFMU "J. Gërvalla", Kryetari i Komunës z. B. Ramosaj, nënkryetari z. S. Cacaj dhe DKA inauguruan klasen parashkollore. Klasa u kompletua me të gjitha mjetet didaktike dhe inventar, e gjithë kjo falë projektit SHPRESE të CARITASIT Zvicran.

Dt.03.06.2022. Nxënësit: En Mushkolaj, Albulena Tahiraj, Ardrin Dobraj Benisa Loshaj nga Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri" dhe Blerti Jollaj nga SHFMU "Heronjtë e Dukagjinit", në Kampin Rinor të organizuar nga UNDP, nxënësit ishin të shoqëruar nga prof. A. Tolaj. Zyra e Kryetarit Ramosaj, mundësoj nxënësve udhëtimin për në Brezovicë dhe anasjelltas.

Dt.04 dhe 14.06.2022. Testi i Arritshmërisë është mbajtur edhe në Deçan, pjesëmarrës ishin 421 nxënës, të klasave të IX-ta nga 18 SHMU, të ndarë në 2 qendra.

Dt.04.06.2022. Në organizim të DKA-së, është mbajtur trajnim njëditor me mësimdhënësit që në vitin shkollor 2022/2023, do të marrin nxënësit e klasave të para. Tema e trajnimit: Zbatimi i kurrikulës në procesin mësimor. Trajner, Pedagogu H. Balaj.

Dt.04.06.2022. Në ambientet e IAAP "Tafil Kasumaj" në Deçan, u zhvillua Gara Komunale e Diturisë, në Gjuhën Angleze. Garuan rreth 90 nxënës të klasave 6, 7, 8 dhe 9-të nga shkollat fillore të mesme të ulëta të komunës sonë.

Dt.06.06.2022. Në të gjitha shkollat me aktivitete të ndryshme është organizuar Shënimi i Ditës Botërore të Mjedisit.

Dt.13.06.2022. Rezultatet e garës komunale në lënden e Gjuhës Angleze:

Klasa e VI-të

1. Aris Shala SHFMU "Jusuf Gërvalla"

2. Elda Kuçi SHFMU "Lidhja e Prizrenit"

3. Jara Hadergjonaj SHFMU "Lidhja e Prizrenit"

3. Enkela Zeqiraj SHFMU "Lidhja e Prizrenit"

Klasa e VII-të

1. Edi Bufaj SHFMU "Lan Selimi"

1. Andi Osdaudaj SHFMU "Isa Boletini"

2. Diellëza Hulaj SHFMU "Lidhja e Prizrenit"

2. Ema Tahiraj SHFMU "Drita"

3. Elina Selmanaj SHFMU "Rexhep Kadrijaj"

Klasa e VIII-të

1. Arsa Bajraktari SHFMU "Lidhja e Prizrenit"

2. Arleta Hasanmetaj SHFMU "Bajram Curri"

2. Art Dautaj SHFMU "Lidhja e Prizrenit"

3. Adeonë Rexhaj SHFMU "Drita"

3. Erza Imeraj SHFMU "Jusuf Gërvalla"

Klasa e IX -të

1. Korab Berisha SHFMU "Lidhja e Prizrenit"

1. Suela Alaj SHFMU "Lidhja e Prizrenit"

2. Elsa Kadrijaj SHFMU "Rexhep Kadrijaj"

2. Ana Hadergjonaj SHFMU "Lidhja e Prizrenit"

3. Alban Gecaj SHFMU "Lan Selimi"

Dt.14.06.2022. Pas instalimit të pajisjeve për filtrimin e ujit për pije, nga Organizata UNMIK në Kosovë, dy shkollave të komunës sonë, SHFMU "Rexhep Kadrijaj" dhe SHFMU "Dëshmorët e Baballoqit", sot për nxënësit e këtyre shkollave ju dhuruan shishe shumëpërdorimshe - donacion nga përfaqësuesit e UNMIK znj. N. Abdurrahmani dhe z. A. Lataj,

Dt.14.06.2022. Drejtoria e Arsimit organizoi takim pune me drejtorët e shkollave. Tema të takimit ishin: përfundimi i këtij viti shkollor dhe përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2022/2023.

Dt.15.06.2022. DKA, së bashku me Kryetarin e Komunës z. Bashkim Ramosaj, kanë ndarë rreth 100 mirënjohje për nxënësit fitues të garave të organizuara nga DKA në fusha të ndryshme: kreativitet, kulturë, sport dhe të diturisë.

Nxënësit tonë, pos sukseseve të treguara në nivel komunal, të suksesshëm ishin edhe në gara regjionale, nivel vendi, por edhe në gara ndërkombëtare.

Komuna, për të gjithë fituesit ka ndarë edhe mirënjohje, notes dhe një stilolaps.

DKA, falenderon të gjithë akterët që ishin bashkëpjesëmarres në këtë rrugëtim.

Dt.17.06.2022. 12 SHFMU në komunën tonë janë përfituese të printerëve, tonerave dhe të pakove me letra. Ky donacion është vazhdimësi e trajnimit të mësimeve të cilët u certifikuan gjatë vitit 2021, nga OJQ KOPF me përkrahjen e UNFPA-së.

dt.18.06.2022. Testi i Maturës 2022, u zhvillua në tri qendra:

Qendra numër 1: Gjimnazi "Vëllezërit Frashëri"

Qendra numër 2: Shfmu "Lidhja e Prizrenit" dhe

Qendra numër 3: IAAP "Tafil Kasumaj", rreth 320 maturantë në të tri qendrat.

Shtator

-1 shtator fillimi i vitit të ri shkollor 2022/2023, nisë më greva në gjithë sektorin e arsimit.

-Organizimi i Ekskursionit me nxënës maturantë 2022, në Shqipëri (2 SHML).

-Konkurs për rekrutimin e stafit arsimor.

-Zyrtarët e DKA-së janë për kujdesur për ndryshimet (e mundshme, sipas kërkesave dhe nevojave të punëtorëve të arsimit) në listat e pagave të sektorit të arsimit.

-Ndarja e teksteve shkollore në shkolla nga zyrtaret e DKA-së.

Tetor

- Takim me drejtorët e shkollave, fillimi i vitit të ri shkollor 2022/2023, përgatitjet e duhura për vitin shkollor 2022-2023.

-Ndarja e teksteve shkollore.

-Mbarimi i grevës në Arsim.

- Me datën 18.10.2022 Komandanti i RC-W Kol.Ivano Marota, që përfaqëson Kontigjentin Italian të PC-W, i dorzojë shfmu "Heronjtë e Dukagjinit" në Gllogjan, paisje të teknologjisë informative për 10 klasa parafillore: Tableta interaktiv, Laptop, Projektor.

- Vizitë pune në SHFMU "Esad Mekuli" në Maznik, gjatë punimeve në renovimin e Eficiencës së Energjisë dhe Energjia e Ripërtërishme.

- Vizitë pune në shkollën e Lumbardhit, ku po ndërtohet shkolla e re, shfrytëzova rastin t'ju uroj nxënësve të kësaj shkolle fillim vitin e ri shkollor.

-Në muajin tetor në shkollë "Maxhun Çekaj" në Irzniq kanë filluar punimet, ku do të bëhet renovimi i tërësishëm i objektit të mbrendshëm, pjesë e investimit janë edhe banjot, dyert, qeramika etj., investim nga MASHTI –it dhe Komuna, është paraparë më kohë investimi në këtë shkollë, por ka qenë në procedurë ankimore nga bizneset në OSHP. Po punohet pa u penguar procesi mësimor.

- Përrurimi i shkollës së re "Drita" në Gramaqel. Me investimet e bëra, objekti i ri ofron kushte shumë të mira për mësim, një ambient i ngrohtë dhe i përshtatshëm për nxënësit dhe komunitetin.

-Tryezë pune, Policia e Kosovës "Ndhmon parandalimin dhe luftimin e trafikimit me njerëz dhe parandalo dhunën në familje", pjesëmarrës: drejtorë shkollash, nxënës të 3 shkollave të qytetit dhe të tjerë.

-Zyra e Financave në DKA, kryerja e pagesave, zotimeve dhe procedurave tjera, sipas kërkesave të drejtorëve të shkollave.

-Zyrtarët e DKA-së janë për kujdesur për ndryshimet (e mundshme, sipas kërkesave dhe nevojave të punëtorëve të arsimit) në listat e pagave të sektorit të arsimit.

Nëntor

- Vizita pune në shkollën “Isa Boletini” në Isniq, Prapaqan, Llukë e Epërme, Beleg, Rastavicë, Prejlep, Strellc i Epërm, Strell i Ulët, Drenoc.
- NPL "Hixhiena" vizituan shkollën "Rexhep Kadrijaj" në Restavicë, ku u pritën nga drejtori Blerim Selmonaj bashkë me mësimdhënës dhe nxënës.
- Qëllimi i këtij bashkëpunimi ishte dorëzimi i komposterëve për kompostim të mbetjeve të gjelbërta dhe të kafta, poashtu u mbajt një ligjeratë nga ana e ekspertëve mjedisorë se çfarë është komposti dhe cila është rëndësia e tij rreth ndikimit në mjedis!
- Në shkollën “Jusuf Gërvalla” u mbledhën fidane në vlerë rreth 500 euro, dhuruar nga NPL “Hixhiena” në Deçan.
- Vendimi nga komisioni për perfituesit e bursave komunale për student në Universitetet Publike.
- U zhvilluan Garat Komunale në Hendboll - në kategorin e femrave, dhe meshkujve.
- Garat u organizuara në Hendboll nga Shoqata e Pedagogëve të Kulturës Fizike në bashkëpunim me DKA-në dhe e përkrahur nga zyra e Kryetarit të Komunës z. Bashkim Ramosaj.
- Në shkollën “Heronjë e Dukagjinit” u mbajt trajnim për përdorimin e mjeteve të digjitalizuara në procesin mësimorë, ku u konfiguruan tabelat elekteonike dhe mësimdhënësit moren njohuri të reja për përdorimin e tyre.
- Me investimin e Komunës dhe MASHTI-T kanë filluar punimet në shkollën "Dëshmorët e Baballoqit" në Baballoq, ku përfshihen lysterja e brendshme, dyert, ndriqimi në shkollë dhe inventari i administratës.
- Vizitë shkollës “Faik Konica” në Ratish i Ulët, ku janë duke vazhduar punimet në ndertimin e shkollës së re dhe janë në përfundim e sipër.
- Sot vizituan shkollën “Faik Konica” në Ratish i Ulët, ku janë duke vazhduar punimet në ndertimin e shkollës së re dhe janë në përfundim e sipër.
- IAAP “Tafil Kasumaj”, u mbajte Olimpiada e Matëmatikës.
- Drejtori i DKA-së z. Besnik Hulaj, priti në takim përfaqësuesin nga Solidar Suisse Kosova, z. Arif Kadriu - menaxher. U bisedua për bashkëpunim të vazhdueshëm, me theks të veçantë arsimit profesional, bashkëpunimi me bizneset për praktikë profesionale të nxënësve tone.

- Kryetari i Komunës, z. Bashkim Ramosaj priti në takim përfaqësuesit e Organizatës Ndërkombëtare për Migrim IOM-Programi EU - CSP IV. Paraprakisht falënderojmë donatorët e programit EU-CSP (Bashkimin Europian dhe Ministrinë për Komunitete dhe Kthim) si dhe Organizatën Ndërkombëtare për Migrim - IOM për përkrahjen e vazhdueshme që i ka dhënë komunës tonë si dhe bashkëpunimin në realizimin e shumë projekteve të cilat kanë qenë pjesë e planit zhvillimor strategjik të Komunës së Deçanit.
- Projekt ky në vlerë prej 15,869.00 eurove për shkollën “Drita” Gramaçel.
- Implementimi i këtij projekti do të ketë ndikim pozitiv në përmirësimin e ofrimit të shërbimeve edukativo-mësimore për nxënësit e shkollës “Drita” në Gramaçel. Shkolla “Drita” është shkollë multietnike dhe është shembull i gjithëpërfshirjes.
- Konkursi për rekrutimin e stafit mësimor.
- Zyra e financave në DKA, mobilizim i kujdesshëm rreth shpenzimit të mjeteve buxhetore në afatet kohore. Ekzekutimi i kërkesave të shkollave, kërkesa për inventarë.
- Zyrtarët e DKA-së janë për kujdesur për ndryshimet (e mundshme, sipas kërkesave dhe nevojave të punëtorëve të arsimit) në listat e pagave të sektorit të arsimit.

Dhjetor

- Ora e parë mësimorë iu kushtua personave më aftësisë së kufizuar, siç është e paraparë sipas Kalendarit për shënimin e aftësisë së kufizuar. U mbajtën ligjërata dhe aktivitete kushtuar kësaj dite në shkolla.
- Është bërë publikimi i rezultateve përfundimtare nga Shoqata e Matematikanëve të Kosovës nga Garat Republikane të OMK 2023.
- Në prag të festave të fundvitit së bashku me kryetarin e Komunës z. Bashkim Ramosaj kemi shpërndarë dhurata për fëmijët e parafillores në shkollat e komunës sonë, dhe fëmijët me nevoja të veçanta.
- Në shkollën “Jusuf Gërvalla“ në Prapaqan, së bashku me Kryetarin e Komunës z. Bashkim Ramosaj, përruam kabinetin e TIK-ut dhe kabinetin e Shkencave Natyrore, ku tani e tutje nxënësit mund të zhvillojnë aktivitetet e tyre mësimore në këto drejtime.
- Kanë filluar punimet e ndërtimit të rrethojave në Gjimnazin “ Vëllezërit Frashëri “ në Deçan, dhe rregullimin e trotuarit në atë pjesë.
- Vizitë në shkollën e Pobergjës.
- Konkursi për rekrutimin e stafit mësimor.
- Konkurs për zgjedhjen e drejtorit të ri në SHFMU “Faik Konica” në Ratish.
- Zyra e financave në DKA, në muajin Dhjetor janë përcjellën lëndët e zotura, është bërë realizimi i tyre sipas afateve kohore, njëherit është bërë mbyllja e avanseve për vitin 2022 (për të gjitha shkollat).
- Zyrtarët e DKA-së, janë për kujdesur për ndryshimet (e mundshme, sipas kërkesave dhe nevojave të punëtorëve të arsimit) në listat e pagave të sektorit të arsimit.
- Takim pune në MASHT, Më Ministren e Arsimit dhe drejtoret e DKA-ve.
- Zyrtaret e DKA-së vizita në shkolla sipas plan programit të paraparë.
- Përgatitja e dosjes për ndryshimin e emrit të shkollës nga SHFMU “Bajram Curri” në “Haki Povataj” në Strelc i Epërm.
- Themelimi i tre komisioneve: për ndarjen e Bursave Komunale, Mësimdhënësin më të Dalluar, dhe Kodin Etikë në shkolla.

SQARIM:

Aktivitetet e përditshme të zyrtarëve të DKA-së kanë vazhduar.

- Realizimi, përcjellja e obligimeve financiare për shkolla nga zyrtarja Gj. Haklaj.
- DKA, Procedurat për konkurset - rekrutimi i stafit (punëtorëve) të ri arsimor, sipas kërkesave të shkollave, janë përkujdesur zyrtarët Xh. Bozhdaraj dhe B. Cacaj.
- Vazhdimisht kryhen obligimet administrative, pëlqime, vendime, kërkesa e shkresa tjera zyrtare nga zyrtari B. Prekalla.
- DKA, ndryshimet e nevojshme në listat e pagave për punëtorët arsimor për muaj, janë përkujdesur zyrtarët Z. Malaj, B. Prekalla dhe B. Cacaj.
- Stafi i DKA-së, gjatë kësaj periudhe viziton shkollat në komunën tonë. Nga afër u pa zhvillimi i procesit mësimor në këto institucione.
- DKA, bashkëpunon me Drejtoritë tjera në Komunë, me MASHTI-n, SIA-Pejë, Këshillin e Prindërve në Deçan, me SBASHK-un në Deçan, Policinë e Kosovës-Deçan, QKMF “Adem Ukëhaxhaj” në Deçan, KFOR-in, OJQ-të vendore dhe ndërkombëtare.

Në bashkëpunim me shkollat, bëhet:

- Organizimi në vazhdim i trajnimeve të mësimdhënësve, konform kërkesave dhe mundësive.
- Organizimi i vazhdueshëm trajnimeve të ndryshme për nxënës, konform kërkesave të kohës.

-Garat me nxënësit e shkollave tona:

- Projekti: Garat e diturisë (mësimore), kulturore dhe sportive në nivel komunal për vitin shkollor 2021/2022, me nxënësit e shkollave tona nënivele shkollë dhe komunal kanë filluar dhe po vazhdojnë për vitin shkollor 2021/2022, sipas kalendarit përgatitur nga DKA.
- Olimpiada e Matematikës, niveli komunal dhe republikan (2022),
- Garat e Fizikës niveli komunal dhe republikan (2022),
- Garat në nivel komunal në lëndën e: Matematikës, Fizikës, Gj. Shqipe, Gj. Angleze (2022),
- Garat sportive niveli komunal, regjional dhe republikan (2022),
- Garat e recitatorëve, niveli komunal (2021-22).

Investimet në shkolla gjatë periudhës së parë të vitit 2022:

- Shkollat tona edhe këtë periudhë janë furnizuar me materiale të ndryshme shpenzuese dhe didaktike (nga DKA dhe Komuna).
- Kanë vazhduar punimet në ndërtimin e objekteve shkollore nga vitet prapaprake edhe pse me intensitet më të vogël (investime nga MASHTI).
- Kanë vazhduar projektet në infrastrukturën shkollore të mbetura nga vitit 2021, disa kanë përfunduar, tjerat po vazhdojnë punimet, e në disa tjera presim të fillojnë punimet (investim nga Komuna e Deçanit).**

1. Gjimnazi “V. Frashëri”, Lidhja (ura termike) në mes të objektit të shkollës dhe s. së sportit.
2. SHMT “T. Kasumaj”, projekti i Qendrës për Orientim në Karrierë.
3. SHFMU “D. e Baballoqit” Projekti i kanalizimit -ujërat e zeza.
4. SHFMU “L. Selimi” paralelja në Llukë të Ultës, Rrethoja e Oborrit.
5. SHFMU “B. Curri” në Strellc të epërm, Rrethoja e Oborrit.
6. SHFMU “J. Gërvalla” paralelja në Dubovikë, Rrethoja e Oborrit.
7. SHFMU “D. e Kombit” në Strellc të ultës, Rrethoja e Oborrit dhe e fushës sportive.
8. SHFMU “E. Mekuli” në Maznikë, Depo (shupa) e druve për nxemje.

9. SHFMU “K. V. e Llukës” në Llukë të epërme, Depo (shupa) e druve për nxemje.
10. SHFMU “L. Prizrenit” në Deçan klasat e prafillorëve.
11. SHFMU “S. Vokshi” në Prejlep, oborri.

-Po ashtu, shkollat tona ndërkohë janë përkrahur dhe perkrashen vazhdimisht edhe nga komuniteti (nga njerëzit vullnet mirë, mergimtarë, etj).

-SHFMU “Heronjtë e Dukagjinit” në Glllogjan, u përrua objektit i ri i shkollës.

-SHMT “Tafil Kasumaj” në Deçan, ka filluar ndërtimi i palestrës sportive.

-Gjimnazi “V. Frashëri”, Lidhja (ura) në mes të objektit të shkollës dhe s. së sportit.

-SHMT “T. Kasumaj”, ndërtimi i Qendrës për Orientim në Karrierë.

-SHFMU “D. e Baballoqit”, kanalizimi – vija (ujërat e zeza), afër objektit

-SHFMU “Ardhmëria” në Beleg, në shkollën “Ardhmëria”, ishte bërë në tërësi dixhitalizimi i klasave me smart TV, lloptop dhe pajisje përcjellëse. U funksionalizua kabineti i TIK-ut më kompjuterë. Kabineti i shkencave natyrore Fizikë - Kimi – Biologji. Kabineti i shkencave shoqërore dhe Biblioteka e shkollës e renovuar. Këto investime u mundësuan nga zyra e kryetarit Ramosaj, donatorëve dhe përkrahjes nga DKAdhe angazhimit të drejtorit të shkollës z.U. Hasaj.

-SHFMU "Dëshmorët e Vokshit" në Pobërgjë, ka bërë furnizimin me mjete didaktike mësimore për lëndën e biologjisë. Mjetet financiare u siguruan nga buxheti i shkollës.

-Gjimnazi “V. Frashëri”, Muzeu i shkollës u inaugurua, kjo falë përkrahjes së donatorëve dhe angazhimit të drejtorit të shkollës z.H. Qorraj.

-SHFMU "Jusuf Gërvalla" Prapaqan. Komuna me CARITASI-n ZVICRAN, për parafillorët, kompletton klasën në bashkëfinancim. Klasa u kompletua me mjete didaktike dhe inventar.

-SHFMU “Drita” në Gramaçel, rregullohet kanalizimi i ujrave të shkollës (investon Komuna).

-SHFMU "Lidhja e Prizrenit" – Deçan, CARITASI zvicran. Për parafillorët, kompletton klasën e tyre përmes projektit "SHPRESE". Klasa u kompletua me mjete didaktike dhe inventar.

➤ Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës dhe aktiviteteve në Drejtorinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural në Komunën e Deçanit që janë planifikuar periudhën Janar – Dhjetor 2022.

1. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA – Listimi i aktiviteteve që janë planifikuar për periudhën vjetore janar – dhjetor 2022:

- Përgatitja e planit të punës për vitin 2022
- Hapja e afatit për aplikim për grante komunale për fermerët Deçanas;
- Ndarja e mjeteve të punës për fermerët fitues të granteve komunale;

- Organizimi i takimeve dhe seminareve të ndryshëm me fermer;
- Hapja e kanaleve të ujitjes në gjithë territorin e komunës së Deçanit;
- Themeli i komisionit për njoftimin e fermerëve për procedurat e aplikimit për subvencione dhe grante;
- Përgatitja e stafit për afatin e aplikimeve për subvencione dhe grante;
- Hapja e sezonës së korrje shirjeve;
- Mbajtja e panairit të ushqimeve (produkteve) tradicionale;
- Përgatitja e raportit për fillimin e të mbjellave;
- Vizita në terren tek fermerët dhe tek fermerët përfitues të garantëve;
- Themelimi i shoqatave të ndryshme;
- Shpërndarja e mekanizmit bujqësorë për fermerët nga Komuna e Deçanit;

2. AKTIVITETE E IMPLEMENTUARA – Listimi i aktiviteteve të implementuara gjatë periudhës raportuese nga DBPZHR:

- Është hartuar plani punës nga DBPZHR për vitin 2022;
- Është bërë përgatitja e planeve të ndryshme zhvillimore;
- Është hapur afati për aplikim në projektin ‘‘Mbështetje fermerëve nga Komuna e Deçanit me nga një Mëshqerrë barrëse Raca Hollshtajn’’;
- Janë shpërndarë 15 palë Gërshërë për qethtarët tanë për qethjen e deleve;
- Janë shpërndarë 40 Spërkatëse;
- Janë shpërndarë 70 Motokultivatora;

- Janë shpërndarë 22 krerë mëshqerra barrëse për 22 fermer nga Komuna e Deçanit nga Kontingjenti i parë;
 - Është përpiluar raport i veçantë për mbjelljet pranverore;
 - Janë mbajtur punëtori dhe trajnime për fermerët prodhues të pemëve, perimeve dhe të Blegtorisë;
 - Është përpiluar raporti dhe planifikimi për korrje – shirjet për vitin 2022;
 - Është përcjellë rendimenti i kulturave pranverore;
 - Është bërë përcjellja dhe raportimi i korrje – shirjeve;
 - Janë ndihmuar fermerët me derivate gjatë korrje – shirjeve;
 - Është ngritur komision i veçantë për informimin e fermerëve për aplikimet për subvencione – pagesave direkte për vitin 2022;
 - Është hapur afati për aplikim për pagesa direkte nga MBPZHR;
 - Është mbajtur ‘‘Panairi Veror i Produkteve’’ nga Deçani;
 - Është hartuar plani vjetor për mbjelljet vjeshtore;
 - Është bërë përcjellja e mbjelljeve vjeshtore;
 - Është organizuar ‘‘Panairi i Ushqimeve Tradicionale dhe Dita e Gështenjës’’;
 - Është përmbyllur me sukses ‘‘Afati për aplikim për subvencione – pagesave direkte’’.
 - Është bërë grumbullimi i të dhënave, rezultateve dhe prodhimtarisë bujqësore për 823 fermerë aplikues;
 - Janë kryer me sukses të gjitha procedurat për dhënien në menaxhim të Vend gjuetisë së Përbashkët ‘‘Lojza’’;
 - Është nënshkruar kontrata me shoqatën gjuetare ‘‘Agim Selmanaj’’ për dhënien në menaxhim të Vend gjuetisë së Përbashkët ‘‘Lojza’’;
-
- Janë vizituar mbi 75 fermerë të ndryshëm gjatë gjithë vitit;
-
- Janë hapur dhe mirëmbajtur mbi 25 kanale të ujitjes në territorin e Komunës së Deçanit;
 - Janë lëshuar 10 flete lëshime për prerje të masës drusore në pyje private;

- Janë organizuar mbi 30 trajnime të ndryshme në shërbim të fermerëve deçanasë;
- Është themeluar shoqata e pronarëve të pyjeve private;
- Janë shpërndarë 66 mëshqerra barrëse të racës Hollshtajn Frizis për fermerët nga Komuna e Deçanit nga kontingjenti i dytë (Donacion nga Komuna e Deçanit dhe OZHR Mëshqerra);

➤ **Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike**

Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike, konkretisht sektori për Mbrojtje, Shpëtim duke u bazuar në misionin dhe qëllimet e tij gjatë vitit 2022 në përgjithësi ka arritur që ti kryej punët dhe detyrat e planifikuara një vit më parë rreth parandalimit, evitimit, rekomandimeve të rreziqeve të mundshme nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera.

Vitin 2022 në territorin e Komunës së Deçanit e kanë përcjellë situata emergjente të natyrave të ndryshme si: zjarre, vërshime, fatkeqësi në komunikacion etj.

Duhet cekur vërshimet që kanë ndodhur në fund të muajit Nëntor të cilat kanë shkaktuar dëme materiale si në shtëpi banimi, në infrastrukturë rrugore etj.

Sektori për Mbrojtje, Shpëtim po ashtu gjatë vitit është marrë edhe me punë dhe detyra tjera që dalin nga objektivat dhe planifikimet e drejtorisë në mënyrë periodike ashtu siç janë të planifikuara në Planin e Punës për vitin 2022.

Raporti vjetor do të përmbajë planifikimet e parapara, situatat emergjente, planet të reja të punuara, dokumentet e nevojshme ku të gjitha këto do të jenë të përpiluara në formë tabelare në baza mujore dhe vjetore.

Sektori për Shërbime Publike në kuadër të organizimit dhe të strukturës së tij mbi punën dhe aktivitetet e ka të organizuar me zyrtarët e saj si: në fushën e menaxhimit të mbeturinave, zyrtar për ndërtim, zyrtar për Transport Publik si dhe detyra e punë shtesë që dalin nga drejtoria.

Sektori i Shërbimeve Publike sipas planifikimeve vjetore primare ka qenë realizimi i projekteve në infrastrukturën rrugore, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e tyre, zgjerimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqeve të gjelbëruara, zgjerimin dhe mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik, planifikimin dhe ndërtimin e parqeve dhe shesheve të komunës, menaxhimin, kontrollimin dhe pastrimin e të gjitha shesheve që i përkasin komunës, ndërtimin e rrjetit të ujësjellësit, ndërtimin dhe mirëmbajtjen e rrjeteve të kanalizimit atmosferik dhe ujërave të zeza, mbikëqyrje punët

e ndërmarrjes publike, rregullimin e trafikut dhe transportit urban, mirëmbajtjen e pastërtisë së qytetit (fshirje-larje), shenjëzimin horizontal e vertikal të komunikacionit publik, si dhe kujdeset për mirëmbajtjen e autoparkingjeve publike. Po ashtu pjesë e aktiviteteve janë edhe punët e përbashkëta që janë në bashkëpunim me ndërmarrjen komunale dhe regjionale siç është, kompania NPL “Higjiena”, ndërmarrja regjionale

“Hidrodrini”, ndërmarrja regjionale për ujë të tokave “Drini i Bardhë”, po ashtu bashkëpunim dhe asistim ka pas edhe me KEDS – Njësia Deçan.

Bashkëpunim për zhvillimin e aktiviteteve dhe bashkërendim të punëve në veçanti ka pasur me NPL “Higjiena” që shumica e punëve të menaxhimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjen e hapësirave publike, mirëmbajtjen dhe rregullimin e varrezave dhe lapidareve të Dëshmorëve i ka të kontraktuar me kontratën “Në Shtëpi”.

Raporti vjetor i punës do të bartë në vete të gjitha punët e kryera në formë tabelare dhe grafike gjatë vitit në mënyrë kronologjike ashtu si kanë qenë të planifikuara në vitin paraprak.

Sektori për Mbrojtje dhe Shpëtim

<u>Nr.</u>	<u>Aktivitetet</u>	<u>Periudha</u>
1.	Përgatitja e planeve të punës, raportin vjetor dhe dokumente tjera bazike për vitin 2021/22	Dhjetor 2021
2.	Përgatitja e Dokumentacionit (lëndëve të miratuara) për Arkivim	Janar
3.	Përcjellja dhe monitorimi i pastrimit të rrugëve dhe trotuareve nga bora	Shkurt
4.	Takime të rregullta me Policinë, Kfor-in dhe organizata tjera	Gjatë vitit
5.	Pjesëmarrje në takime të rregullta të KKSBB-së, gjatë vitit janë mbajtur 3 takime	Gjatë vitit
6.	Bashkëpunim dhe kontakt të vazhdueshëm me NJ. P. Z. Sh. – Deçan	Gjatë vitit
7.	Komunikim i vazhdueshëm dhe bashkëpunim me QRAKE-Pejë	Gjatë vitit
8.	Dalja në terren për vlerësimin e rreziqeve të mundshme si nga: rryma, shtëpi të pabanuara (rrënuara) etj., përpilimi i raporteve dhe dhënia e rekomandimeve	Gjatë vitit

9.	Donacion nga KFOR-i Italian, pajisje teknike për NJPZSH – Deçan	Maj
10.	Gjatë vitit 2022 Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike ka pranuar 277 kërkesa në Intranet ku 263 janë miratuar, 6 refuzuar, 4 të pezulluara dhe 1 e anuluar	Gjatë vitit
11.	Njoftim/apel qytetarëve për vetëdijesim dhe kujdes nga zjarret. Njoftimi është bërë në formë të video mesazhit si dhe në formë të shkruar ku është shpërndarë në tërë territorin e Komunës së Deçanit.	Qershor
12.	Përpilimi i planit “Plani për vlerësimin e rrezikut në ndertesa kolektive në Komunën e Deçanit”	Gjatë vitit
13.	Azhurnimi në INTRANET i kërkesave të qytetarëve dhe organizatave të ndryshme të cilat adresohen në Drejtorinë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.	Gjatë vitit
14.	Pritja dhe efikasiteti në punë rreth nevojave dhe kërkesave të bashkatdhetarëve.	Korrik-Gusht
15.	Monitorimi, koordinimi dhe mbikëqyrja së bashku me NJPZSH-në rreth zjarreve fushore dhe malore. Zjarre fushore janë 44, zjarre teknike 26, zjarre malore 27, shtëpi banime e posllome 17	Gjatë vitit
16.	Azhurnimi i Planeve për Mbrojtje dhe Shpëtim nga Fatkeqësitë Natyrore dhe Fatkeqësitë tjera të shkollave dhe Institucioneve Publike në komunën e Deçanit.	Shtator
17.	Projekti zgjerimi i rrjetit të kamerave në qytetin e Deçanit fillon prej Stacionit Policor, te ura e Demës e deri te udhkryqi në Carrabreg, pastaj nga qendra drejt rrugës ”Salih Çeku” dhe rruga e Manastirit te kroni si dhe nga qendra, rruga “Haki Povataj” deri tek shkolla e mesme teknike “Tafil Kasumaj”.	Tetor
18.	Planifikimi i projekteve dhe i buxhetit për vitin 2023 për sektorin Mbrojtje, Shpëtim	Tetor
19.	Analiza e punëve dhe detyrave të planifikuara dhe të realizuara për vitin 2022	Nëntor
20.	Me dt. 20 Nëntor ndodhën vërshime të cilat shkaktuan dëme të konsiderueshme materiale në tërë territorin e komunës së Deçanit. Me këtë rast është formuar komisioni për vlerësimin e dëmeve të cilët kanë dalë në terren dhe kanë bërë vlerësimin e dëmeve si dhe kanë përpiluar raportin me detaje i cili do t’u dërgohet institucioneve përgjegjëse.	Nëntor
21.	Përgatitja e planit vjetor të punës për vitin 2023	Dhjetor

Shënim:

Radiolidhjet e dorës janë jashtë funksionit për shkak të baterive të shpenzuara si dhe Radio-lidhjet bazë nëpër BL janë të demoluar pjesërisht.

Të njëjtat kanë nevojë për servisim komplet si dhe i tërë rrjeti i komunikimit.

Inspektori i parandalimit nga zjarri

- Në fillim të çdo muaji të periudhës së parë dhe të dytë të vitit kalendarik, janë hartuar Planet e punës për vitin kalendarik dhe çdo herë me shkrim është njoftuar edhe Drejtori i Drejtoratit për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime dhe AME - Departamenti i parandalimit - Prishtinë
- Hartimi i Raportit të punës për periudhën tre mujore të vitit 2022
- Hartimi i Raportit të punës për periudhën gjashtë mujore të vitit 2022
- Hartimi i Raportit të punës për periudhën nëntë (9) mujore të vitit 2022
- Hartimi i Raportit të punës për periudhën dymbëdhjetë mujore për vitin 2022

	Nr. i përgjithshëm i daljeve në terren të inspektorit për parandalim ndaj zjarrit	Konstatime dhe verifikim të zjarreve	Hartimi i raporteve të zjarreve dhe vërtetimeve të dërguara Policisë së Kosovës		Dhënia e pëlqimeve në dokumentacion Investivo-teknik	Aksidente në Komunikacion		
			Raporte të zjarrit	Vërtetime nga zjarri		Të lënduar	Të vdekur	Intervenime të NJPZSH në aksidente
Janar	3	5	3					
Shkurt	1	3						
Mars		32						
Prill	18	8	1	1				
Maj	8	5						
Qershor		3						1
Korrik		17						
Gusht	2	13	2	1				3
Shtator	2	5	2					
Tetor	16	5	1					2
Nëntor	6	1						
Dhjetor	1	1	1	1				
Gjithsej:	57	98	10	3				

Numri i përgjithshëm i zjarreve dhe llojet e intervenimeve gjate vitit 2022													
	Lloji i intervenimit	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor
1.	Zjarre malore	0	1	13	5	3	0	6	1	0	0		
2.	Zjarre fushore	0	1	12	2	0	2	4	7	1	0		
3.	Zjarre në objekte banimi dhe objekte përcjellëse	2	0	1	0	0	0	3	2	2	0	1	1
4.	Zjarre në objekte afariste banesore	0	0	0	0	0	0	0	0	0	1		
5.	Zjarre në automjete	1	0	1	0	0	0	0	0	0	0		
6.	Të ndryshme	2	1	5	1	2	1	4	3	2	4		
	Gjithsej:	5	3	32	8	5	3	17	13	5	5	1	1

Sektori për Shërbime Publike

Infrastruktura rrugore dhe mirëmbajtja gjatë vitit 2022

1. Asfaltimi i rrugës “Bjeshka e Strellcit”

1	Hapje, ngjeshje dhe shtruarje me zhavorr	4 km
2	Asfaltim	10 km



2. Zgjerimi i rrugës së qendrës

1	Zgjerimi i rrugës së qendrës - Asfaltim i ri	300 m
2	Shtresa e tretë e asfaltit në rrugën e qendrës me hyrje anësore	5 km



3. Asfaltim i rrugëve të reja me kontratën “Lot 2” - 2022

1	Maznik	2.8 km
2	Restovic	2.8 km
3	Gramaqel	2.8 km
4	Irzniq	0.47 km
Total	Asfaltimi	8.87 km
Totali	Shtruarje me zhavorr tek varrezat e Maznikit	500 m



3. Asfaltimi i Rrugës “Sadriaj” – Gramaçel - 350m



3. Përfundimi i shëtitorës në rrugën e Manastirit - 800m



3. Ndërtimi i qendrës turistike në bashkëpunim me IPA, GIZ dhe EU





3. Ndërtimi i qendrës turistike në bashkëpunim me IPA, GIZ dhe EU – Faza II-të



4. Ndërtimi dhe inventarizimi i objektit “Shtëpia Alpine Bjeshtatare Shkëlzen Haradinaj”



3. Elektrifikimi i Bjeshkës së Belegut



1. Përfundimi i ndërtimit në Memorialët e Dëshmorëve

1	Strellc i Ulët	
2	Lëbushë	
3	Dubovik	
4	Voksh	
5	Vlera totale	126,000.00€



Aktivitetet e komunës bashkë me NPL “Higjiena” – Kontrata “Në Shtëpi”


Njëra ndër aktivitetet kryesore për vitin 2022, Komuna e Deçanit konkretisht Sektori për Shërbime Publike e ka pasur me Ndërmarrjen Publike Lokale “Higjiena” me punët e kontraktuara sipas kontratës “Në Shtëpi”.

Në vijim do ti paraqesim punët dhe aktivitetet në shumë fusha sipas kontratës “Në Shtëpi”, si:

1. Mirëmbajtja e hapësirave të hapura publike

Mirëmbajtja e hapësirave publike duke përfshirë mbjelljen, ujitjen, kositjen, fshirjen dhe larjen e rrugëve kryesore dhe trotuareve në qytet, pastrimi dhe mirëmbajtja e fontanave, mirëmbajtjen e hapësirave publike dhe mobilierisë urbane, riparimi dhe vendosja e shenjave të komunikacionit, punë eskavatori sipas kërkesës së Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.





1.2 Dekorimi i qytetit për festat zyrtare dhe festat tjera

Dekorimi i qytetit për të gjitha festat zyrtare, vendosja e flamujve, ndërrimi i flamujve, vendosja e shtyllave të flamujve, dekorimi i qytetit për festat e fundvitit dhe dekorime tjera që janë parë të nevojshme.



1.3 Mirëmbajtja e kanalizimit të ujërave të zeza dhe atmosferike

Mirëmbajtja e kanalizimit të ujërave të zeza, gropave septike dhe nyjave sanitare në territorin e komunës së Deçanit, zhbllokimi dhe pastrimi i pusetave të kanalizimit të ujërave të zeza, zbrazja e gropave septike në institucionet publike, germimi, furnizimi, ndërrimi i gypave deri në

funksionalizimin e plotë të kanalizimit të ujërave të zeza m-gjatësi, zhbllokimi dhe pastrimi i puseta të kanalizimit të ujërave atmosferike, furnizimi dhe vendosja e kapakëve të puseta të betonit dhe metalit (të kanalizimit të ujërave të zeza dhe atyre atmosferike).



1.4 Mirëmbajtja e Memorialëve të Dëshmorëve

Plani për mirëmbajtjen e memorialëve të dëshmorëve, pastrimi dhe mirëmbajtja e memorialëve të dëshmorëve, germimi i dheut për krijimin e hapësirave të reja për mbjelljen e barit në oborrin e Komplekseve të Dëshmorëve duke përfshirë prerja dhe kositja e barit, largimi i mbetjeve mes

pllakave apo gurëve si dhe rregullimi i pemëve dekorative. Pastrimi-ngjyrosja e shkronjave dhe portreteve të memorialëve të Dëshmorëve. Ndërrimi i ulëseve të reja, shportat e mbeturinave si dhe mirëmbajtja e rrethojave etj. Mirëmbajtja e varrezave publike në të gjithë territorin e Komunës së Deçanit.



2.Eliminimi i deponive ilegale

Gjatë vitit 2022 është bërë eliminimi i deponive ilegale, nivelizimi dhe bartja e tyre në vende të caktuara për deponim. Gjatë këtij viti është bërë eliminimi i 4 deponive ilegale, rrafshimi dhe mbjellja e barit në ato deponi ku ka qenë e nevojshme. Në disa deponi është bërë edhe rrethimi dhe njoftimet për mos hedhjen e mbeturinave.



3. Lapidare, Memoriale, Varreza të Dëshmorëve

Në vitin 2022 Drejtoria për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike, Sektori për Shërbime Publike i ka kushtuar kujdes të veçantë lapidaret, memorialët dhe varrezave të Dëshmorëve në ndërtimin dhe renovimin e tyre. Në vitin 2021 ka pasur projekte në vazhdim të vitit 2021 po ashtu edhe projekte të reja. Renovim ka pasur në lapidarin në fshatin Lumbardh si dhe Irzniq, ndërsa si lapidare të reja të ndërtuara ka pasur në: Belle,

Lebushë, Strellc i Ulët dhe Carrabreg i Epërm. Ndërsa si varre të reja të ndërtuara ka pasur një në fshatin Prilep. Duke cekur se mirëmbajtjen, pastrimin dhe kujdesin gjatë gjithë vititit për të gjitha memorialët në Komunën e Deçanit i ka kryer kompania NPL “Higjiena”.



4. Shpërndarja e Kompostueseve

Në vitin 2022 Komuna e Deçanit përkatësisht Drejtoria e Shërbimeve Publike së bashku me kompaninë lokale “Higjiena” dhe në bashkëpunim me GIZ, GAC përmes projektit Shërbime të Qëndrueshme Komunale kemi bërë implementimin e projektit në zonën pilot për shpërndarjen e kompostueseve. Ky projekt synon zvogëlimin e mbeturinave të gjitha rrjedhjet e mbeturinave në të gjitha fazat e tyre nga gjenerimi, përmes

mbledhjes, seleksionimit dhe riciklimit, trajtimit deri në deponimin përfundimtar nëpërmjet përdorimit dhe trajtimit adekuat të materialeve biologjike përmes kompostimit si dhe aplikimit dhe ngritjes së sistemit të diferencuar të mbeturinave sipas fraksionit. Deri tani kemi bërë shpërndarjen e mbi 40 kompostueseve në disa ekonomi familjare, biznese dhe institucione shkollore. Ky projekt do të gjejë implementim edhe në vitet në vazhdim.



5. Vendosja e kamerave në qytetin e Deçanit

Projekti Zgjerimi i Rrjetit të Kamerave në Qytetin e Deçanit fillon prej Stacionit Policor, te ura e Demës e deri te udhëkryqi në Carrabreg, pastaj nga qendra drejt rrugës ”Salih Çeku” dhe rruga e Manastirit te kroni, si dhe prej qendrës rruga “Haki Povataj” deri tek shkolla e mesme teknike “Tafil Kasumaj”.



Transporti Rrugor – Publik

Gjatë vitit 2021 është bërë përcjellja e rregullt e linjave të transportit publik urban dhe rural në qytetin e Deçanit dhe fshatrat e tij. Bashkëpunimi me Institucione si: Policia e Kosovës, Inspektoratin e Ministrisë, përfaqësues të komuniteteve etj. Koordinimi mbi aktivitetin e transportit publik të mallrave dhe udhëtarëve me kompanitë publike dhe taksitë individuale.

Bashkëpunim me Policinë e trafikut për lirim të trotuareve nga automjetet. Gjithashtu është bërë caktimi i drejtimeve rrugore për qarkullimin e automjeteve në zonën urbane dhe lokacionet e limituara për parkingje.

Është bërë vazhdimi i lejeve dhe licencave për taksitë dhe kombibusët që operojnë në Komunën e Deçanit. Mbikëqyrja dhe vendosja e shenjave të komunikacionit si ato horizontale ashtu edhe vertikale sipas planifikimeve dhe nevojave si në qytet ashtu edhe në fshatra.

Sipas nevojës është bërë propozimi për mbylljen e përkohshme të rrugëve në rast nevojë (festa, protesta), etj.

Si dhe punë dhe detyra tjera sipas planifikimit dhe sipas ligjit dhe rregullores në fuqi, gjatë vitit 2022.

6. Punët dhe aktivitetet tjera sipas D.SH.P – së

Aktivitetet tjera gjatë vitit kanë qenë edhe detyrat shtesë të pa planifikuara si: ndërhyrja në pikat e rrezikut nga vërshimet, pastrimin e sallës së sportit dhe stadiumit në Deçan, pastrimi gjatë vitit i PGM-ve, kanalet e ujitjes, prerja e vegjetacionit etj.

Përfundim

Spektori për Mbrojtje dhe Shpëtim gjatë vitit 2022 ka kryer punët dhe aktivitetet e parapara në shumicën e planifikimit.

Raporti i punës përshkruan aktivitetet e vitit 2022 nga Spektori për Mbrojtje e Shpëtim në bashkëpunim edhe me sektorët tjerë komunal po ashtu edhe me institucionet lokale që kanë të bëjnë në fushën e menaxhimit të emergjencave si në parandalim, rekomandime, ndërhyrje në eliminimin e pikave të rrezikut dhe detyrave tjera ashtu siç është e paraparë sipas organo-gramit dhe përshkrimit të detyrave .

Spektori për Shërbime Publike gjatë vitit 2022 në kuadër të planifikimeve dhe detyrave që i ka pas ka përmbushur dhe realizuar në përgjithësi direktivat e dalura nga kryetari dhe planifikimi i vitit 2021 i bërë nga drejtoria.

Prioritet dhe vëmendje të veçantë i janë kushtuar ambientit, infrastrukturës rrugore, bashkëpunimit dhe koordinimit me NPL “Higjiena” rreth realizmit dhe përmbushjes së kontratës “Në Shtëpi” menaxhimit të projekteve që kanë në kuadër të Drejtorisë dhe po ashtu detyrat dhe punë shtesë gjatë periudhës së vërshimeve në muajin Nëntor.

Pjesë e aktiviteteve kanë qenë dhe takimet ndër komunale, në nivelet tjera qendrore si me Asociacionin e Komunave të Kosovës, Ministrinë e linjës, Organizatat qeveritare dhe jo qeveritare që kanë pasur të bëjnë me projektet e Komunës së Deçanit si GIZ, GAC, DEMOS, etj.

Vitin e ka karakterizuar pritja e palëve, kërkesat si dhe dalja në terren për problemet e caktuara si rrugë, kanalizime, transport publik, mirëmbajtja dhe tema tjera që e lidhin punën e aktivitetin e Drejtorisë për Mbrojtje, Shpëtim dhe Shërbime Publike.

➤ Drejtoria për Inspektion

Drejtorati për Inspekcione i Komunës së Deçanit gjegjësisht inspektorët e këtij drejtorati, gjatë vitit kalendarik 2022 kanë kryer punët dhe detyrat e punës konform Ligjeve dhe akteve nënligjore si dhe rregulloreve komunale me të cilat rregullohet puna e inspektorëve sipas fushave përkatëse, duke ju përmbajtur Planit të Punës së Drejtoratit për vitin 2022.

Në Kuadër të Drejtoratit gjatë këtij viti kanë qenë të sistemuar Inspektori i Tregut, Inspektori i Mbrojtjes së Ambientit, Inspektori i Ndërtimit (i angazhuar me Kontratë mbi Shërbimet e Veçanta), Inspektori i Veterinës (i angazhuar me Kontratë mbi Shërbimet e Veçanta) dhe Inspektori i Bujqësisë që njëkohësisht është edhe shef i inspektorëve.

Që nga viti i kaluar inspektori Sanitar ka kaluar në Agjensionin e Veterinës dhe Ushqimit dhe prej atëherë nuk ka Inspektor Sanitar në nivelin Komunal.

Secili nga Inspektorët ka vepruar sipas detyrës zyrtare, sipas kërkesave dhe ankesave të palëve dhe sipas kërkesave të organeve tjera kompetente.

Në mënyrë permanente është bërë mbikëqyrja inspektuese e subjekteve tregtare dhe hoteliere, me theks të veçantë lidhur me respektimin e orarit të punës, vendosjen e çmimeve të mallrave për tregtim, afati i skadimit të produkteve ushqimore, ndërtimet pa leje apo në kundërshtim me lejen ndërtimore të lëshuar nga Drejtorati për Urbanizëm, Planifikim dhe Mbrojtje të Mjedisit. Në mënyrë permanente është bërë kontrolli i therjes së kafshëve në thertoret e licencuara.

Sipas kërkesave të operatorëve ekonomik është bërë pranimi i lokaleve të subjekteve sa i përket kushteve minimale higjienike teknike dhe të mbrojtjes në punë.

Janë bërë kontrole sipas kërkesës së Policisë së Kosovës (me të cilët ekziston një bashkëpunim mjaft i mirë), posaçërisht për mallrat e hasura në transportin rrugor pa dokumente përkatëse përcjellëse, mosrespektimin e orarit të punës, sidomos nga subjektet hoteliere, por edhe sipas denoncimit të palëve në polici për pa rregullsitë e hasura të subjektet tregtare sidomos nga lëmi i çmimeve dhe afati i skadimit të artikujve ushqimor.

Janë kryer edhe punë tjera sipas fushë veprimtarisë të secilit nga inspektorët.

Në tabelën në vijim po e prezantojmë aktivitetin e inspektorëve:

Inspektori	Kontroll inspektuese në terren sipas detyrës zyrtare	Kontroll inspektuese në terren sipas kërkesës së personave fizik dhe juridik	Procesverbale të hartuara për konstatimin e gjendjes	Aktvendime	Kërkesa për gjykatat kompetente
I Tregut	50	37	87	14	4
I Ndërtimit	42	10	42	9	3
I Mbrojtjes së Ambientit	5	3	48		3 gjoba mandatorë 3 kallxime penale
I Veterinës	48	3	8	/	1
I Bujqësisë		42	29	2	/
Gjithsejt:	145	95	214	25	14

Kërkesë: Meqenëse nga inspektori i ndërtimit ka akteve ndime për rrënim të objekteve të ndërtuara pa leje apo në kundërshtim me lejen ndërtimore të lëshuar nga Drejtorati për Urbanizëm, për ekzekutimin e tyre është e domosdoshme që të iniciohet procedura e prokurimit për kontraktimin e një Operatori Ekonomik për rrënim të objekteve pa leje ndërtimore apo në kundërshtim me lejen ndërtimore.

➤ **Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim**

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim gjatë vitit 2022 ka realizuar këto aktivitete:

Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim gjatë vitit 2022, në kuadër të fushë veprimtarisë ka ofruar këto punë/shërbime zyrtare të bazuar në Statutin e Komunës, në harmoni me ligjet e Kuvendit të Kosovës, aktet tjera nënligjore, Rregulloret e miratuara nga Kuvendi Komunal i Deçanit, dokumenteve strategjike dhe planin e punës për vitin 2022. Punët/shërbimet e Drejtorisë për Zhvillim Ekonomik fokus të veçantë i është kushtuar hartimit dhe realizimit të politikave zhvillimore, marrja e masave sa më të përshtatshme për të nxituar më tutje zhvillimin e përgjithshëm ekonomik të Komunës së Deçanit, krijimin e kushteve sa më të favorshme, infrastrukturës dhe mjedisit sa më të përshtatshëm për zhvillim të ndërmarrjeve të vogla, mesme, për një zhvillim sa më të qëndrueshëm. Fokus të veçantë vazhdon t'i kushtohet promovimit të zhvillimit ekonomik, turizmit, zbutjes së papunësisë, duke mundësuar gjenerimin e vendeve të reja të punës. Pra, Drejtoria për Zhvillim Ekonomik vazhdon me intensifikimin e angazhimeve të saj drejt përmirësimit të klimës së të bërit biznes, promovimin e Komunës së Deçanit si një komunë atraktive, për investitorët strategjik për të investuar dhe për tu vizituar, gjithmonë e hapur ndaj ideve inovative dhe projekteve të reja smart, gjithmonë duke ofruar shërbime/konsulenca profesionale.

1. Harton politikat e zhvillimit ekonomik për komunën;
2. Bashkëpunon me organet e tjera komunale me qëllim të informimit për plane zhvillimore;
3. Bënë analiza që shërbejnë si bazë për planet zhvillimore;
4. Cakton dhe propozon prioritetet e zhvillimit në fusha të ndryshme e sidomos në fushën e Turizmit;
5. Organizon ekupe të ekspertëve të ndryshëm për banim të planit të zhvillimit ekonomik në nivel komune dhe hartimin e projekteve kapitale për përfitimin e donacioneve;
6. Harton strategjinë e zhvillimit të përgjithshëm afatmesëm dhe afatgjatë për komunën;
7. Bashkëpunon me organet relevante në nivelin lokal dhe atë qëndror;
8. Bashkëpunon me ekspertë të fushave të ndryshme që ofrojnë përvoja të ndryshme në zhvillim;
9. Jep këshilla me interes për ekonominë private-reale;
10. Merr pjesë në seminare-promovime të karakterit zhvillimor;

11. Kryen edhe punët tjera në fushën e zhvillimit ekonomik.

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtori:

- Regjistrimi i bizneseve fillestare (të gjitha bizneset individuale B.I, shoqëritë aksionare, ortakëri e përgjithshme, ortakëri e kufizuar, shoqëria e huaj), tregtare, ndërmarrjet shoqërore dhe kooperativat bujqësore;
- Regjistrimi i ndryshimeve në biznes;
- Pajisje me çertifikata të reja me Numër Unifikues;
- Pajisja me informata shtesë për biznes;
- Protokollimi i të gjitha lëndëve që kanë të bëjnë me biznes;
- Raportet javore dhe mujore pranë MTI;
- Vërtetime për persona fizik që nuk ushtrojnë veprimtari biznesore;
- Vërtetime që nuk posedojnë obligime të taksës komunale për ushtrimin e veprimtarisë afariste biznesore;
- Shqyrtimi i lëndëve: kërkesave, ankesave dhe të ngjashme;
- Ngarkesa e taksës komunale për biznese;
- Konsulenca me palët/bizneset si dhe
- Punë dhe angazhime tjera në komisione.

Sipas zyrës për biznese, numri i bizneseve të regjistruara nga data 01.01.2022 deri me datën 31.12.2022 janë të regjistruara **107** biznese të reja, të cilat biznese në bazë të deklarimeve të tyre punësojnë **162** punëtorë. Bizneset fillestare brenda ditës pajisen me çertifikatën e biznesit me Numër Unifikues të biznesit, si dhe jepen konsulenca të ndryshme të kësaj natyre për ta krijuar një ambient sa më të volitshëm për regjistrim dhe të gjitha ndryshimet e nevojshme në biznes. Shikuar në bazë të kësaj periudhe ky numër i bizneseve të regjistruara duket si vijon:

Lloji i Pronësisë	Numri i Bizneseve
Biznes individual	61
Ortakëri e përgjithshme	/
Ortakëri e kufizuar	/
Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar	46
Shoqëri Aksionare	/
Ndërmarrje në pronësi të huaj	1
Ndërmarrje publike	/
Kooperativë bujqësore	/
TOTALI:	107

- **Ndryshimet në Biznes / Informata Biznese**

Nr.	Shërbimi/Lënda	Totali
1.	Shuarje të bizneseve	20
2.	Kërkesë për shtimin apo heqjen e aktivitetit	52
3.	Kërkesë për informata	78
4.	Kërkesë për shtim apo ndryshim të njësisë	9
5.	Kërkesë për ndryshim të adresës	24
6.	Kërkesë për ndryshimin e drejtorit apo përfaqësuesit të autorizuar	29
7.	Kërkesë për çertifikatë dublikat	6
8.	Kërkesë për ndryshim të emrit tregtarë	4
9.	Kërkesë për ndryshim të kapitalit	7
10.	Kërkesë për ndryshimin e pronarëve/aksionarëve	16
11.	Çertifikata të reja për biznese fillestare	107
12.	Çertifikata të ripërtërira me numër Unik	89
13.	Vërtetime për persona fizik që nuk ushtrojnë veprimtari biznesore	64
14.	Vërtetime për persona fizik që ushtrojnë veprimtari biznesore	15

➤ Aktivitetet e Drejtorisë

- Pjesëmarrje në punëtorinë “Rrjeti Rajonal për Ngritje të Kapaciteteve” e organizuar nga Asociacioni i Komunave të Kosovës;
- U realizuan takime me përfaqësuesit e institucioneve të nivelit qendror, organizatave vendore dhe ndërkombëtare me qëllim të arritjes së marrëveshjes/bashkëpunimit për të gjetur mundësinë e përkrahjes/financimit të projekteve zhvillimore, të cilat do të ndikojnë në zhvillimin ekonomik të komunës së Deçanit dhe sektorit privat/bizneseve të cilat operojnë në territorin e komunës së Deçanit;
- Janë realizuar takime me përfaqësuesit e bizneseve ku janë diskutuar për sfidat, pengesat, mundësitë dhe planet zhvillimore;
- Vizitë Drejtorisë për Ekonomi dhe Zhvillim në komunën e Gjakovës, Pejës dhe Junikut. Qëllimi i vizitës ishte krijimi i bashkëpunimit midis drejtorive komunale të qyteteve fqinje;
- Takim me kryetarin e Lezhës, z. Pjerin Nderu në organizimin e Ambasadës së Shqipërisë;
- Takim me kryetarin e Ulqinit në lidhje me evenimentet që do organizohen në komunën e Deçanit;
- Pjesëmarrës në hapjen e Sezonit Turistik në Lezhë;
- Vizitë në disa biznese në Durrës me qëllim të promovimit të Panairit Veror që mbahet në komunën e Deçanit;
- Janë realizuar takime me përfaqësuesit e shoqatave dhe organizatave joqeveritare me qëllim të koordinimit të aktiviteteve në nivelin lokal, të cilat do të ndikojnë në përmirësimin e jetës ekonomike, sociale;
- Drejtoria për Ekonomi dhe Zhvillim ka vizituar bizneset prodhuese (21 biznese);
- Pjesëmarrës në organizimin e Panairit të Lezhës në Prishtinë;
- Thirrje për aplikim për subvencionim me mjete financiare për NMVM lansuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë përmes Agjencisë për Investime dhe Përkrahjen e Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA);
- Raportimi i Planit të Veprimit të Strategjisë për Zhvillim Ekonomik Lokal 2019-2022 - Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal;
- Takim me përfaqësues të Agjencisë Italiane si dhe përfaqësues nga Organizata Celim në lidhje me lansimin e projektit NaturKosova;
- Thirrja për Propozime e Programit për Zhvillim Rajonal - Investime Kapitale - Zyrtar e Agjencisë për Zhvillim Rajonal;
- Pjesëmarrës në organizimin e Organizatës Germin - Tema: Mundësi për gratë ndërmarrëse;
- Draft Strategjia e Turizmit - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Krijimi i listës me Shtëpitë Akomoduese për Bjeshkët e Nemuna - Përmes Organizatës së Swisscontact në Kosovë;
- Pjesëmarrës në projektin NATURKOSOVA, projekt që promovon turizmin - vlera e projektit **1.8 milion** euro;
- Takim me përfaqësues nga Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, zyrtar i lartë z. Arian Krasniqi me të cilin diskutuam për atraksionet turistike të komunës së Decanit;
- Pjesëmarrës në dëgjimin publik lidhur me Projektligjin për turizmin - Komisioni Parlamentar për Ekonomi, Industri, Ndërmarrësi dhe Tregti;
- Pjesëmarrës të fazës së tretë të projektit – DEMOS;

- Krijimi i listës së të gjitha Hoteleve/Restauranteve dhe Resorteve të Deçanit që mund të jenë target group i projektit tonë, si dhe poashtu edhe Statistika të përditësuara për sektorin e Turizmit, Hotelierisë etj., sikurse edhe arritjet/sfidat/nevojat për Sustainable Tourism Management, Prishtina REA;
- Krijimi i grupit për plotësimin dhe ndihmesën në aplikimin e Ministrisë së Ekonomisë, thirrjen për financimin e OJQ-ve në fushën e TIK-ut, energjisë dhe sektorin mineral;
- Thirrja për propozime: Skema e Granteve “Programi për Zhvillim Rajonal të Balancuar“ PZHRB 2022, Start-up dhe Biznes Ekzistues Lot I dhe Lot II;
- Takim me përfaqësues nga Jakova Innovation Center - Projekti "Të bashkuar drejt fuqizimit të të rinjve, grave dhe grupeve të pafavorizuara";
- Pjesëmarrës në Programin Gov4SAA që do t'u mundësojë Nëpunësve Civil dhe pjesëmarrësve të tjerë të kalojnë përmes praktikës së zhvillimit të bizneseve, të zhvillojnë idenë, të ndërtojnë një ekip (kryesisht me nëpunës civilë, bashkëpunim me sektorin privat dhe OSHC), të zhvillojnë prototipa, t'i testojnë dhe t'i zbatojnë ato
- Takim me Swisscontat –Diskutimi i temave në lidhje me projektet e turizmit në komunën e Deçanit;
- Takim me përfaqësues nga Universiteti Publik Haxhi Zeka në Pejë - Tema e takimit: Turizmi dhe Objektet Turistike në Komunën e Deçanit, mundësia e prezantimit të tyre etj.;
- Vizitë në disa biznese të komunës së Deçanit me qëllim të njoftimit nga afër për problemet, vështirësitë, sfidat që po kalojnë si biznese;
- Vizitë në disa biznese prodhuese të komunës së Deçanit (biznese që eksportojnë produkte jashtë Kosovës);
- Pjesëmarrje në Trajnimin "Komunat Gjithëpërfshirëse-Asociacioni i Komunave të Kosovës”;
- Pjesëmarrës në Punëtorinë – "Nxitja e zhvillimit të qëndrueshëm dhe rajonal përmes projekteve për investime kapitale", organizuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe në partneritet me UN-Habitat Kosovë;
- Pjesëmarrës në trajnimin me temën “Pjesëmarrja e Komunave në programet IPA” - Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale;
- Pjesëmarrës në Tryezë: BASHËKPUNIMI DHE KOORDINIMI NË FUSHËN E TURIZMIT - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Pjesëmarrës në Punëtorinë me temën: “Shqyrtimi i Elementeve nga Menaxhimi i Ciklit të Projekteve (Project Cycle Management)” sipas praktikave të BE-së duke përfshirë të gjitha fazat përkatëse si identifikimi i projekteve, zhvillimi i koncepteve, analiza e hisedarëve dhe kërkesave, analiza e rreziqeve, zhvillimi i kornizës logjike, hartimi i projekteve sipas formatit të BE-së, zhvillimi i buxhetit, zbatimi, procedurat e prokurimit, monitorimi dhe vlerësimi, si dhe raportimi - Agjenci për Zhvillim Rajonal në zonën Perëndimore të Kosovës;

- Pjesëmarrës në Punëtorinë me temën: Shqyrtimi i dokumenteve strategjike si Planet Zhvillimore Komunale si dhe ato në nivel rajoni me qëllim të identifikimit të projekteve të mundshme. (Prezantim dhe shqyrtime nga 6 Komunitat e rajonit dhe AZHR-Perëndim) si dhe Zhvillimi i shkathësive në hartimin e analizës së hisedarëve dhe kërkesave të tyre, si dhe analizën e rreziqeve për projekt propozimet e identifikuar paraprakisht. (Projekte komunale apo ndër-komunale dhe rajonale) - Agjenci për Zhvillim Rajonal në zonën Perëndimore të Kosovës;
- Pjesëmarrës në Punëtorinë me temën: "Sfidat e implementimit të legjisllacionit për dhënien në shfrytëzim dhe këmbim të pronës komunale"- Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale;
- Takim i Kolegjiut për Zhvillim Ekonomik Lokal-Asociacioni i Komunave të Kosovës;
- Pjesëmarrës në Punëtorinë me temën: "Pemës së Problemit", si dhe përmbyllja e ciklit prej 5 punëtorive të rregullta javore - Agjenci për Zhvillim Rajonal në zonën Perëndimore të Kosovës;
- Pjesëmarrës në Sesionin Informues dhe Punëtorinë Para-përgaditore lidhur me Thirrjen për projekt-ide për Investime Kapitale, organizuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe në partneritet me UN-Habitat Kosovë;
- Takim me përfaqësues nga NGO "Syri i Vizionit" (SiV) – Tema e takimit: Identifikimi i mundësive dhe iniciativave për bashkëpunim dhe zhvillim ndërkomunal;
- Pjesëmarrës në takimin e organizuar nga Ministria e Ekonomisë - Prishtina Digital Summit 2022;
- Pjesëmarrës në Punëtorinë me temën: "Prezantimi i Draftit të Model-Profilut Ekonomik të Komunave", - Instituti Kosovar për Qeverisje Lokale;
- Pjesëmarrës në organizimin nga Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal në bashkëpunim me projektin DEMOS - Punëtorinë e përbashkët për Hartimin e Programit Nacional për Zhvillim Ekonomik Lokal 2022-2029 (Punëtorinë dy ditore 3 dhe 4 Tetor);
- Takimi me përfaqësues nga KIESA z. Jasharaj – Diskutimi në lidhje me ndihmesën e bizneseve në aplikimin e thirrjeve nga KIESA;
- Pjesëmarrës në takimin konsultues ku do të prezantohet Draft dokumenti Kriteret për brendimin e rajoneve zhvillimore - Organizuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal (MZHR);
- Takim me zyrtar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal - Takimi në lidhje me projektin e fituar në Ministrinë e Zhvillimit Rajonal (Projekti Objekti i Trashëgimisë Kulturore) –Korrik 2022;
- Pjesëmarrës në Punëtorinë - Prezantimi dhe validimi i draft-analizës së investimeve kapitale të realizuara sipas rajoneve zhvillimore të Kosovës për vitin 2022, organizuar nga Ministria e Zhvillimit Rajonal dhe në partneritet me UN-Habitat Kosovë;
- Takim me Fondacionin Kosovar Trashëgimia Kulturore pa Kufij (CHwB Kosova);
- Takim i organizuar në Komunën e Deçanit për përfaqësuesit nga Projekti NaturKosovo. (Pjesëmarrës nga Shoqata Celim, Utalaya Foundation, Associazione Italiana Turismo Responsabile, Club Alpino Italiano, pjesëmarrës nga komuna e Junikut dhe Pejës etj.);
- Pjesëmarrës në Punëtorinë "Bashkëpunimi ndërkomunal dhe ndërkufitar" të organizuar nga Qendra e Trajnimit të Asociacionit të Komunave të Kosovës;

- Pjesëmarrës në tryezën: SIGURIA DHE MIRËMBAJTJA E PRODUKTEVE TURISTIKE - SWISS FOUNDATION FOR TECHNICAL COOPERATION;
- Pjesëmarrës në tryezën e përbashkët me qëllim të koordinimit dhe bashkëpunimit rreth planeve dhe aktiviteteve në fushën e turizmit - Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, Departamenti i Turizmit;

➤ **Zhvillimi dhe promovimi i turizmit**

Në këtë vit është punuar në promovimin dhe zhvillimin e Turizmit dhe janë mbajtur aktivitete të ndryshme:

- Kupa e Gjeravicës 2022 në Bjeshkën e Belegut;
- Përgatitja dhe shpërndarja e Fletushkave të bjeshkëve;
- Shtigjet e shënjestuara për ecje/hiking në Bjeshkën e Roshkodolit, Bjeshkën e Prilepit, Bjeshkën e Belegut, Zallin e Rupës, Bjeshkën e Deçanit dhe Carrabregut deri tek Maja e Gjeravicës;
- Promovimi i bukurive natyrore dhe burimeve turistike në zonat rurale dhe malore në këto bjeshkë dhe komunën e Deçanit përmes tri (3) videoklipeve;
- Rregullimi i hapësirave të Qendrës Informuese Turistike;
- Lansimi i web-faqes së turizmit të Deçanit <http://decanitourism.org>;
- Programi ndërkufitar Kosovë dhe Mali i Zi;
- Koordinimi mes Qendrës së Informimit dhe OJQ-ve të ndryshme për bashkëpunime në Turizëm;
- Bashkëpunimi me SWIS CONTACT; USAID; CDF; ADF; ECO; Bashkimi Evropian; GIZI;
- Ngjitja në Via Ferrata në Ditën e Çlirimit të Deçanit, aksion për promovimin e Via Ferrata;
- Koncert i madh në qendër të qytetit në ditën e dytë përmbyllëse të Panairit Veror 2022;
- Panairi Tradicional Veror i organizuar me 45 biznese dhe kompani nga qytetet e Kosovës si dhe shtetet e tjera fqinje si Shqipëria, Mali i Zi dhe Maqedonia;
- Bashkëpunimi dhe vizita të ndërlidhura me Bashkinë e Lezhës dhe Ulqinit;
- Bashkëpunim dhe vizitë në qytetin e Tetovës në lidhje me promovimin e turizmit;
- Emisione të ndryshme në TV, karakter promovimi i Turizmit;
- Vizitë në fshatin turistik Belle, qëllimi i vizitës: promovimi i turizmit;
- Vizitë në fshatin turistik Pleqe me anë të cilës pretendojmë promovimin e turizmit;

- Bashkëpunimi dhe zhvillimi i projektit me OJQ “Shkëlzen Haradinaj” - “Tourism hubs for better offer in less advantaged mountaiouns areas”;
- Bashkëpunim me OJQ “Kosovo Mountain Club” në lidhje me turizmin dhe projektet që kanë të bëjnë me zhvillimin e turizmit në komunën e Deçanit;
- Organizimi për Bashkatdhetarë në Shtëpinë Bjeshkatore Alpine “Shkëlzen Haradinaj” - 30 Korrik 2022;
- Organizimi i Panairit Veror 2022, (Ekspozim i produkteve vendore) - 09 Gusht 2022;
- Aktivitet përurues për hapjen e Qendrës Informuese Turistike në Deçan – 12 Gusht 2022;
- Organizimi i Kampit njëditor për fëmijët (Njoftim në lidhje me rëndësinë e turizmit dhe njohja nga afër e tyre) - 19 Gusht 2022;
- Aktivitet për Promovimin e Resurseve turistike nga Komuna e Deçanit – 14 Shtator 2022;
- Evidentimi i atraksioneve në disa bjeshkë të Deçanit;
- Aktivitet me bizneset e Gastronomisë përgjatë Grykës së Deçanit – Mundësi e promovimit të tyre nga ana e Qendrës së Turizimit;
- Organizimi i aktivitetit për ngjitje te Via Ferrata në Deçan (Promovimi i resurseve turistike) - 25 Shtator 2022;
- Organizimi i ecjes në Majën e Trekufirit;
- Organizimi i ecjes në Majën e Gjeravicës, në Bjeshkën e Strelcit, në Majën e Mariashit, në Liqenin e Zemrës etj.;
- Organizimi i ecjes në Liqenin e Tropojës;
- Organizimi i ecjes në Majën e Rupës;
- Organizimi i eventit me fëmijët e kopshtit “Fatosat”;
- Organizimi i ngjitjes në Via Ferrata;
- Aktiviteti për Promovimin e Resurseve të Deçanit nga RTK - Dokumentari nga Laura Krasniqi;
- Aktiviteti për Promovimin e Resurseve të Deçanit – televizioni T7;
- Dita e Gështenjës në Deçan - 24 Tetor 2022;
- Aktivitet 3 ditor për Via Dinarica 25, 26 dhe 27 Tetor (Shtimi i shtigjeve të reja, markimi, shenjëzimi dhe rregullimi i atyre ekzistuese);
- Organizimi i takimit me bjeshktar - Tetor (diskutimi për sfidat, arritjet dhe pritshmëritë për të ardhmen);

➤ Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër

1. Shefi i Shërbimit njëkohësisht edhe zyrtari për RDPP së bashku me referenten e ndryshimeve kadastrale

Gjatë periudhës për të cilën po raportojmë, përkatësisht prej fillimit të vitit 2022 e deri me datën e përpilimit të këtij raporti, Zyrtari për RDPP ka pranuar gjithsej **657** kërkesa nga palë të ndryshme për realizimin e të drejtave ligjore që dalin nga Regjistrimi i të Drejtave në Pronën e Paluajtshme (RDPP).

Nga të gjitha këto kërkesa deri më tani janë shqyrtuar **629** dhe për të njëjtat janë lëshuar aktvendime adekuate me të cilat palëve i'u është njohtë e drejta ligjore e kërkuar ose ju ka refuzuar e njëjta kërkesë dhe ju ka dhënë e drejta e ankesës në organin e shkallës së dytë. Ndërsa **28** kërkesa janë në procedurë e sipër.

I njëjti ka lëshuar **405** aktvendime për azhurimin e lëndëve të terrenit.

Aktvendimet me të cilat palës i është njohtë e drejta në RDPP, në afat ligjor dërgohen te referenti për ndryshime kadastrale i cili konform këtyre vendimeve bënë azhurimin në librat përkatës të elaboratit kadastral dhe të njëjtat prapë i azhurnon duke i fut të dhënat në kompjuter, përkatësisht në programin e SIKTK.

Krahas këtyre punëve zyrtari për RDPP i cili i kryen edhe detyrat e shefit të shërbimit ka kryer edhe punë tjera nga lëmi i shërbimeve pronëso- juridike si dhe së bashku me referentin për ndryshime kadastrale kanë kryer edhe punë tjera me urdhër të drejtorit.

2. Zyrtarët e mirëmbajtjes së Kadastrit

Në këtë sektor punojnë tre zyrtar për mirëmbajtjen e Kadastrit.

Këta zyrtar gjatë periudhës raportuese kanë pasur **413** azhurime të lëndëve nga tereni sipas kërkesës së palëve siç janë: ndarja e parcelave, bashkimi i parcelave, regjistrimi i objekteve, korrigjimi i sipërfaqeve, korrigjimi i mexhave dhe futja e të dhënave të reja në sistem etj. Këto lëndë të gjitha janë zgjedhur me përjashtim të **12** rasteve të cilat ende janë në procedurë e sipër.

Gjithashtu këta zyrtar gjatë kësaj periudhe kanë lëshuar **12** historiate dhe identifikime të mexhave sipas kërkesave të palëve dhe kanë lëshuar **550** kopje plani.

Gjatë kësaj periudhe raportuese këta zyrtar kanë dal në teren për **4** raste nga domeni pronëso- juridik, e sipas kërkesës zyrtare të bërë nga ana e Komunës së Deçanit, për nevoja të komunës. Si dhe kanë kryer edhe detyra tjera sipas nevojave të cilat paraqiten në këtë shërbim siç janë konsultat me palë dhe punë tjera në zyrë.

3. Referenti për pranimin e palëve

Gjatë periudhës për të cilën raportojmë, referenti për pranimin e palëve ka pranuar gjithsej **1287** kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me dhënien e certifikatave të pronës së paluajtshme, kopjeve të planit dhe vërtetimeve me të cilat vërtetohet se a ka apo nuk ka pala pasuri të paluajtshme, në territorin e komunës.

I njëjti zyrtar i ka proceduar të gjitha këto kërkesa dhe për secilën kërkesë palët janë pajisur me dokumente përkatëse në afatin brenda ditës së paraqitjes së kërkesës. I njëjti punëtor krahas këtyre punëve ka kryer edhe punët e përpunuesit në SIKTK.

Për hir të thjeshtësisimit të të dhënave për punët e kryera të këtyre punëtorëve këtij raporti po ia bashkëngjitem edhe formën tabelare të lëndëve të pranura sipas muajve dhe llojit të kërkesave.

Lloji i lëndëve	Janar	Shkurt	Mars	Prill	Maj	Qershor	Korrik	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Totali
Aktvendimet për ndryshime kadastrale	056	041	070	060	045	054	023	100	063	055	045	045	0657
Azhurimi i lëndëve - terreni	026	014	024	029	039	035	037	046	070	066	078	060	0524
Lëshuarja e certifikatave etj.	214	200	228	224	210	211	279	405	221	202	202	156	2752
Kopje plani	022	042	050	052	050	034	068	072	054	052	032	022	0550
Totali për muaj	318	297	372	365	344	334	407	623	408	375	357	283	4483

Kjo drejtori krahas këtyre punëve të evidentuara më lartë ka kryer edhe punë tjera të parashtruara konform kërkesave të palëve private dhe organeve komunale.

➤ **Drejtorja për Kulturë, Rini dhe Sport**

Gjatë vitit 2022, Drejtoria për Kulturë, Rini dhe Sport ka realizuar këto aktivitete:

- 16.02.2022 - Promovimi i librit “Kosova 1968-1990”, nga autori Shkodran Imeraj;
- 17.02.2022 – “Dita e Pavarësisë së Kosovës”;
- 03.03.2022 – Promovimi i librit “Shekuj drite në Deçan”, nga autori Harun Shabanaj;
- 20.03.2022 – Turniri tradicional i shahut “Zeqë Hasaj”;
- 21.03.2022 – “Dita e Poezisë”;
- 23.03.2022 – Krosi “Rruga e Lirisë”;
- 23.03.2022 - Ekspozita “Nismëtarët e Lirisë”, nga artisti Besart Gashi;
- 24.03.2022 – “Epopeja e Dukagjinit”;
- 27.03.2022 – Gara e Skitarisë “Kupa e Gjeravicës”;
- 04.05.2022 – Ekspozitë me nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme;
- 04.05.2022 – Festivali “Vallja Ppopullore”;
- 05.05.2022 – Turniri tradicional “Luan Haradinaj”;
- 01.06.2022 – “Dita ndërkombëtare e fëmijëve”;
- 09.06.2022 – Turnir në futboll të vogël (në nderim të komandantit Ali Avdiqaj);
- 15.06.2022 – Promovimi i librit “Ecje nëpër kujtime”, nga autori Adem Lushaj;
- 15.06.2022 – Ngjitja në atraksionin “Via Ferrata”;
- 15.06.2022 – Ekspozitë nga “Ars Kultura”;
- 16.06.2022 – “Panairi Veror Deçani 2022”;
- 17.06.2022 – Koncert artistik;
- 30.07.2022 – Takim i kryetarit z. Bashkim Ramosaj me bashkatdhetarët;
- 03.08.2022 – “Akademi Mirënjohje”, me rastin e 40 vjetorit të bashkimit politik të organizatave patriotike - LPK-së;
- 09.08.2022 – Program artistik dhe Panairi Veror, në shenjë mirëseardhje për bashkatdhetarët;
- 11.08.2022 – Dokumentari “Erudi i Ditëve Tona”, mbi jetën dhe veprën e atdhetarit Ali Haxhia;
- 18.09.2022 – Takim me FC “Kosova” në Zvicër;
- 24.09.2022 – “Dita e Gështenjës”;
- 25.10.2022 – “Shënimi i Ditës së Flamurit - 28 Nëntorit”;
- 10.12.2022 – Hapja e Klubit Sportiv të Karatesë “Dukagjini”;
- 17.12.2022 – Turniri Tradicional në Ping-Pong në nderim të dëshmorëve të kombit Enver Halilaj dhe Altin Haskaj;
- 27.12.2022 – Takimi i fundvitit me klubet e sportit dhe Ansamblin e Këngëve dhe Valleve “Deçani”;

Gjatë vitit 2022 Ansambli i Këngëve dhe Valleve “Deçani” ka përfaqësuar shtetin e Kosovës në Festivalin “International Taskopru Culture and Garlic Festival” në Turqi, po ashtu ansambli ka treguar shumë suksese gjatë vitit 2022, me shumë pjesëmarrje nëpër festivale, me fitore të shumë çmimeve kryesore.

Gjithashtu edhe në sport është arritur sukses shumë i madh gjatë vitit 2022, si në fitore, po ashtu edhe në sponzorizim të klubeve sportive.

Në arkivën Komunale gjatë vitit 2022 janë kërkuar lëndë të ndryshme për shfrytëzim dhe janë arkivuar gjithsejt **408** lëndë.

Në bibliotekën e Qytetit “Dëshmorët e Lirisë” dhe në degën e bibliotekës në fshatin Isniq numri i lexuesve gjatë vitit 2022 ka qenë **435**, ndërsa numri i librave të dhuruar nga MKRS dhe nga vetë autorët është **370**.